



RAPORTI VJETOR

2 0 2 3

TIRANË, MARS 2024

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
1. MESAZHI	4
2. KUADRI LIGJOR.....	5
3. RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË “PROGRES – RAPORTIT” TË BE-SË PËR SHQIPËRINË	6
4. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2022.....	8
5. VEPRIMTARIA E AUTORITETIT PËR VITIN 2022	13
5.1. ARKIVI.....	14
5.2. INFORMIMI	17
5.3. MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS	23
5.4. HULUMTIMI SHKENCOR DHE EDUKIMI QYTETAR	26
5.5. SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK	29
6. OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2023	30
7. SYNIMET PËR TË ARDHMEN.....	32
8. DETYRIMET LIGJORE NGA AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSITË NË RASTET KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR APO NUK ËSHTË KONSIDERUAR	33
9. NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR PËR VITIN 2022 DHE EFEKTET E TYRE	34
10. MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA NË VEPRIMTARINË E AUTORITETIT ME QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I MINISTRAVE.....	35
12. NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E AUTORITETIT DHE IMPAKTI I TYRE	38
13. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT - STRUKTURA DHE ORGANIKA E AUTORITETIT	39

HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) është institucion i pavarur, organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë, nga të cilët: 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Shqipërisë, 1 (një) anëtar i propozuar nga Këshilli i Ministrave, 1 (një) anëtar përfaqësues i propozuar nga shoqatat e të përndjekurve politikë dhe 1 (një) anëtar i propozuar nga Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në muajin qershor 2022, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi me shumicë votash bordin e ri drejtues të Autoritetit. Kjo procedurë u ndërmor për shkak të përfundimit të mandatit të Bordit të parë të Autoritetit. Në bordin e ri u zgjodh kryetarja në detyrë e këtij institucioni, znj. Gentiana Sula, anëtari aktual i bordit z. Altin Hoxha, z. Albert Nikolla si propozim i Kryeministrit, z. Gjergj Marku u votua mes 3 kandidatëve nga shoqatat e ish-të përndjekurve dhe z. Skënder Vrioni, si e vetmja kandidaturë nga organizatat e të drejtave të njeriut. Në muajin dhjetor 2022, Kuvendi i Shqipërisë ri zgjodhi në krye të Autoritetit znj. Gentiana Sula .

Në këtë mandat të dytë, në vitin 2023, Autoriteti ka në përbërje anëtarët si më poshtë vijon:

Znj. Gentiana Sula – Kryetare

Z. Albert Nikolla – Anëtar

Z. Altin Hoxha – Anëtar

Z. Gjergji Marku – Anëtar

Z. Skënder Vrioni – Anëtar

Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në ta, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, të së vërtetës, të pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Raporti vjetor i punës për vitin 2023 është hartuar dhe miratuar duke u mbështetur në ligjin organik nr. 45/2015, *“Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, që normojnë dhe rregullojnë veprimtarinë funksionale të institucionit.

Gjatë vitit 2023, Autoriteti ka zhvilluar 57 mbledhje dhe ka marrë 732 vendime, nga të cilat 730 vendime unanime, 2 vendime me mendim kundër, 2 marrëveshje bashkëpunimi. Nëpërmjet një pune voluminoze me përgjëgjësi maksimale kundrejt misionit të institucionit nëpërmjet takimeve periodike, Autoriteti ka realizuar me shumë sukses, marrjen e këtyre vendimeve të rëndësishme, me impakt në fushën e demokratizimit të shoqërisë, për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës, nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit.

1. MESAZHI

Viti 2023 përkon me vitin e parë të mandatit të dytë të Autoritetit. Një sërë sfidash dhe objektivash, bazuar në një plan strategjik ambicioz, u realizuan me sukses. I rëndësishëm në të këtë mision ka qenë thellimi i bashkëpunimit me institucionet e qeverisjes qendrore dhe asaj lokale, si dhe organizatat ndërkombëtare.

- ❖ Disa nga sfidat më të rëndësishme, me të cilat është përballur AIDSSH-ja gjatë këtij viti, në kuadër të konsolidimi institucional kanë qenë:
 - ❑ Miratimi i Planit Strategjik 2023-2028, i cili e vendos Autoritetin përballë objektivash strategjike shumë ambiciozë;
 - ❑ Përgatitja e rregullores së Autoritetit, e cila është ndryshuar për të mundësuar një qasje sa më të mirë të objektivave institucionale me planin strategjik dhe ligjin e rishikuar 45/2015, si dhe Udhëzimeve të ndryshme me në fokus metodologjinë e hetimit administrativ;
 - ❑ Deklasifikimi, një proces i rëndësishëm, i cili i jep frymëmarrje punës së Autoritetit në kuadër të informimit qytetar dhe përsheptimit të procedurave në shërbim të individit. Gjatë vitit 2023 janë deklasifikuar **5 591** njësi arkivore (dosje, fashikuj etj.), me një total prej **237 259** fletë dokumente arkivore.
 - ❑ Në këtë vit, një punë e konsiderueshme është bërë në kuadër të digjitalizimit të dokumenteve. Vetëm gjatë këtij viti është mundësuar digjitalizimi i 1,416,00 faqeve dhe pritet që deri në fund të vitit 2024 të digjitalizohen në total 3,000,000 faqe, gjë që mundëson vënien në shërbim të softit të Arkivës digjitale të financuar nga Qeveria Suedeze.
- ❖ Në fushën e edukimit qytetar, gjatë vitit 2023, është konkretizuar me sukses Marrëveshja ndër-institucionale e Bashkëpunimit me MAS, e cila parashikon të rrisë ndjeshmërinë e institucioneve përgjegjëse për planifikimin e politikave për arsimin parauniversitar, si dhe të të gjithë aktorëve në proces, mbi rëndësinë që ka edukimi për qytetari demokratike, njohja me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, por edhe me mbijetesën, qëndresën dhe solidaritetin e atyre që vuajtën në sajë të kësaj veprimtarie.
- ❑ Në bashkëpunim me MAS, është bërë e mundur nisma për ndërtimin e platformës “*Mësojmë nga e kaluara, burime arsimore të hapura 1944-1991*”, që do të thotë: arkivë, dokumente arkivore, dëshmi gojore. Një platformë interaktive, që nënkupton përfshirjen e të gjithë aktorëve të kujtesës, si institucioneve dhe ekspertëve të arsimit. Për këtë, Autoriteti e ka paraprirë punën me arkivën, e cila përveç mbledhjes, deklasifikimit dhe digjitalizimit, prej dy vitesh po punon me skanimin e dokumenteve dhe me zhvillimin e software-it specifik OCR, që lejon punë të sofistikuar me metoda të avancuara për përdorimin e mëtejshëm të burimeve parësore që disponohen.

- Në muajin mars të vitit 2023, Kuvendi i Shqipërisë miratoi strukturën e re të Autoritetit, me 73 punonjës, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga hallkat kryesore të punës së Autoritetit në përmbushjen e misionit të tij. Struktura e re, u shtua me 8 persona, duke e vënë theksin tek kërkesat për verifikimin e figurave, si dhe kërkimin dhe gjetjen e personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, që funksionojnë si struktura më vete. Kjo gjë ka mundësuar fillimin e procedurave për verifikimin e figurave, si dhe procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës.

Viti 2023, në gjuhën e shifrave, mund të konsiderohet një vit i sukseshëm, i sfidave të përballuara me punë dhe bashkëpunim të konsoliduar mes aktorëve. Në këtë vit ka përfunduar kthimi i përgjigjeve me të gjitha tipet e kërkesave për 575 kërkesa individuale, 16 kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh, 70 kërkesa për të zhdukurit, 72 kërkesa institucionale, sipas së cilave janë verifikuar 224 shtetas, 176 kërkesa për internim-dëbim ose burgim. Gjithashtu janë administruar 112 kërkesa studimore dhe mediatike, janë miratuar 116 vendime vendime të Autoritetit (përfshirë edhe ato të mbartura nga viti 2022), për 1,329 dosje, me një total prej 138,010 faqesh, ndër të cilat është anonimizuar një total prej 10,522 faqesh. Janë skanuar 1,415,000 imazhe, janë digjitalizuar 2,113 dosje fizike dhe 175 dosje të mikrofilmuara, me një total prej 158,268 faqesh dokumente arkivore. Janë realizuar 49 aktivitete brenda dhe jashtë Autoritetit, si dhe botime të ndryshme me në fokus të shkuarën.

Informimi dhe kujtesa nuk është një proces i thjeshtë. E megjithatë, një shoqëri duhet të përballë me këtë debat në mënyrë të hapur e të sinqertë. Synimi ynë është që ky dialog të shkojë përpara, edhe atëherë kur ai nxjerr të vërtetën të dhimbshme.

2. KUADRI LIGJOR

Gjatë vitit 2023, legjislacioni mbi të cilin mbështet dhe organizohet puna e Autoritetit, nuk ka pësuar ndryshime. Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara nga baza ligjore e mëposhtme:

Ligjin nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”; Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”; Ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”; Ligjin nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave Personale” i ndryshuar; Ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror””, i

ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”; Ligjin nr. 119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e Informimit”; si dhe në akte nënligjore të mëposhtme: Vendim i Kuvendit të Republikës nr. 95, datë 22.12.2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit, për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 15.02.2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 28.12.2016 “Për kalimin nën përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi i Ri”, Brenda Territorit të Pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjia nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 515, datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, me anë të së cilës është përcaktuar mjedisi ku AIDSSH do të ushtrojë veprimtarinë e vet; Vendimi nr. 93, datë 27.02.2020, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve, apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Ligj Nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Akte rregullatore të brendshme të Autoritetit: Rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit; Rregullore “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në AIDSSH”, miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 14.04.2017; Rregullore “Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në AIDSSH”, miratuar me Vendimin nr. 25, datë 25.05.2017, të Autoritetit; Rregullore “Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër, apo online në faqen e Autoritetit”;

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Autoriteti ndihmohet nga Sekretariati Teknik, sipas detyrave të përcaktuara në ligjin organik dhe rregullave të mirëpërcaktuara në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Autoritetit. Sekretariati Teknik përgatit dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin, realizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Autoritetit.

3. RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE, PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË “PROGRES – RAPORTIT” TË BE-SË PËR SHQIPËRINË

“Pa paqe, stabilitet, respektim të të drejtave të njeriut dhe qeverisje efektive, të mbështetur në sundimin e ligjit, nuk mund të shpresohet për zhvillim të qëndrueshëm, në një botë me shoqëri të polarizuar, ku vijnë ciklet e konflikteve dhe dhunës”.

Kombet e Bashkuara

Edhe gjatë vitit 2023, Autoriteti ka kontribuar në përmbushjen e rekomandimeve të Grupit të Punës të OKB-së për Personat e Zhdukur (WGEID), ku Kombet e Bashkuara pohojnë për Shqipërinë se, forcimi i ligjit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve në institucionet e drejtësisë dhe përmirësimit të proceseve të drejtësisë tranzitore, ndihmon sigurimin e së vërtetës, e ridimensionon atë dhe u jep zë viktimave, elemente që vënë themelet për zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe në shoqëri.

Autoriteti, gjatë këtij viti, ka bërë hap cilësor në kërkimin dhe gjetjen e vendvarrimeve të dyshuara të të zhdukurve, nisur nga kërkesat e familjarëve dhe të afërmeve të personave të zhdukur.

Është i përfunduar drafti i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të njohura dhe atyre të dyshuara, të personave të zhdukur në këtë periudhë”, që përcakton përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në proces. Drafti i përgatitur i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë, si institucioni kompetent, për të parë harmonizimin me aktet ligjore në fuqi, si dhe Ministrisë së Financave, për të parë efektet financiare që rrjedhin nga ky vendim.

Bashkimi European

Sipas raport-progresit 2023 të Komisionit European në seksionin “On the right to life”¹ nënvizohet “Mbi të drejtën për jetë, u arrit një progres i kufizuar në hetimin e rasteve dhe forcimin e kuadrit institucional dhe legjislativ, për personat e zhdukur që nga koha e komunizmit. Duhet të alokohen burime të mjaftueshme, në përmirësimin e kapaciteteve për të bërë identifikime dhe për të zyrtarizuar marrëveshjet mbi koordinimin institucional në këtë fushë. Duhet të krijohet një burim i vetëm i të dhënave për personat e zhdukur, që të jetë gjithëpërfshirës edhe për publikun. Vullneti i vazhdueshëm politik është i rëndësishëm, për të rritur numrin e rasteve të zgjidhura, si dhe ndërgjegjësimin e publikut, për këtë çështje.”

Në këtë kuadër, Autoriteti ka punuar për përgatitjen e të dhënave mbi personat e zhdukur gjatë kohës së komunizmit, bazuar në dëshmitë e shkruara dhe verbale, si dhe nga zbardhja e komunikatave të Minsitrisë së Brendshme. Është një produkt i Autoritetit, që po pasurohet çdo ditë, sa herë paraqiten kërkesa, dëshmi, apo evidenca nga komunikatat².

Lidhur me forcimin e kuadrit institucional, si dhe koordinimin institucional gjithashtu, Autoriteti ka vijuar diskutimet në tryeza të zgjeruara edhe gjatë vitit 2023, në prani edhe të Prezencës së OSBE-së, të përfaqësuesve të Prokurorisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Zyrës së ICMP-së Tiranë, Institutit të Mjekësisë Ligjore, Institutit të Policisë Shkencore, e në ndonjë rast edhe përfaqësues nga Ministria, për

¹ Raport-Progresi i Komisionit European 2023 faqe 29

² Me teper informacion seksioni “rekomandimet e Rezolutes” pika c

Reformat Ligjore dhe Marrëdhëniet me Parlamentin. Palët, në përfundim të takimit, janë dakordësuar si më poshtë:

- Rolin nistor dhe koordinues që duhet të ketë Autoriteti, në gjitha etapat e procesit, nga kërkimi i eshtrave, gjetja dhe identifikimi i tyre e deri te nderimet dhe memorialet për personat e zhdukur.
- Natyrën administrative të procesit të gjetjes dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve, ndërkohë lejon Prokurorinë që të përfshihet përmes kallëzimit drejt saj, në raste kur gjatë procesit të gjetjes së eshtrave dalin prova, fakte dhe të dhëna, që tregojnë për një krim;
- Instituti i Mjekësisë Ligjore do të përfshihet në proces në çdo rast, në momentin e parë që gjatë kërkimit dhe gërmimit, do të konstatohen mbetje mortore të personave të zhdukur dhe do të bashkëpunojë në gjetjen, pastrimin dhe ruajtjen tyre;
- ICMP-ja do vazhdojë të ketë rol në fazën e rikuperimit të eshtrave të gjetura, individualizimit të tyre (një lloj matrikullimi) dhe të identifikimit të përkatësisë së tyre, përmes krahasimit me profilet e ADN-së së familjarëve të personave të zhdukur;
- Instituti i Policisë Shkencore do të përfshihet në trajtimin e rasteve kur grupi me ekspertë mjekoligjorë do të konstatojë fakte që evidentojnë elementë krimi, etj. Po ashtu, është hedhur edhe ideja e diversifikimit të mundësive për kryerjen e ekzaminimeve të eshtrave dhe profileve gjenetike, çfarë mund të sjellë përfshirjen edhe të këtij instituti, në përcaktime të përkatësisë së eshtrave të gjetura, me profile genetike të familjarëve të të zhdukurve.

4. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2023

a. Të hartojë aktet nënligjore në kuadër të përafrimit me ndryshimet që pësoi ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në zbatim të kësaj direktive Autoriteti ka proceduar me përafrimin e akteve nënligjore, në harmoni me ndryshimet e ligjit nr.45/2015 (i ndryshuar) dhe konkretisht:

- AIDSSH, ndërmori hartimin e draft VKM-së “Për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të njohura dhe atyre të dyshuara, të personave të zhdukur në këtë periudhë”. Janë organizuar disa takime mes palëve të interesuara, për miratimin e VKM-së, si: Autoriteti i Dosjeve, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Instituti i Policisë Shkencore, ICMP-ja dhe OSCE-a, si dhe përfaqësues nga Ministria për Reformat Ligjore dhe Marrëdhëniet me Parlamentin. Draft

VKM e hartuar nga AIDSSH, është dërguar për konsultim pranë Ministrisë së Brendshme, ICMP-së, si institucione përkatëse në marrëveshjen tripalëshe.

- Është përgatitur dhe miratuar me vendim të organit kolegjal, të udhëzuesit “Për rregullat dhe procedurat e verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.
- Është përgatitur propozimi për shtesa dhe ndryshim në draft-Udhëzuesi “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të AIDSSH-së, për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, që aktualisht është në proces.
- AIDSSH, ka shqyrtuar në mbledhjet e organit kolegjal, propozimet për shtesa dhe ndryshime në udhëzues, mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave të qytetarëve; ka hartuar dhe janë shqyrtuar në mbledhjet e organit kolegjal, propozimet për shtesa dhe ndryshim në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së.
- Janë miratuar me vendim kolegjal, 2 marrëveshje bashëpunimi, marrëveshja mes AIDSSH-së dhe Akademisë së Filmit dhe Multimedias “MARUBI”, si dhe marrëveshja e bashëpunimit mes AIDSSH-së dhe Institutit të Historisë së Europës Mesdhetare të Kalijarit, Romës dhe Milanos.
- Është miratuar Plan i Strategjik për periudhën 2023-2028.

b. Të raportojë mbi përfundimet dhe pengesat ligjore që ka hasur Autoriteti gjatë zbatimit të ligjit nr. 45/2015, lidhur me verifikimin e figurave të zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie figure. Pas ndryshimeve ligjore që sollën shfuqizimin e komisioneve “Bezhani” e “Mezini”, Autoriteti të bashkëpunojë me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, me qëllim që t’i drejtohen Autoritetit me kërkesë, për ri – verifikimin e figurës së zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie.

Pas ndryshimeve ligjore dhe interesit të lartë të publikut, për mënyrën si është kryer verifikimi i figurave nga këto komisione, AIDSSH, ka miratuar ngritjen e Grupit të Punës me objekt “Identifikimin dhe njohjen e akteve juridike dhe veprimtarinë e dy institucioneve përgjegjëse, lidhur me procesin e kontrollit të figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë në Republikën e Shqipërisë, listës me bazë të dhënash të dokumentacionit arkivor të krijuar, numrin e zyrtarëve të verifikuar prej tyre dhe rezultatin e verifikimit, procesin e grumbullimit, marrjes në administrim dhe përpunimit të fondit dhe praktikat ndërkombëtare për verifikimin e figurave”.

Në përfundim të punës, Grupi i Punës ka hartuar raportin përmbledhës me 62 faqe, me nivel klasifikimi, ku është identifikuar dhe pasqyruar informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga dokumentacioni arkivor i krijuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse, të përfshira në procesin e kontrollit të figurës të subjekteve të verifikuara. Raporti është miratuar me Vendimin nr. 3, datë 20.06.2023 të Autoritetit. Kopje e raportit është dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Për sa i takon pengesave ligjore, lidhur me verifikimin e figurave të zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie figure, rezulton se për periudhën e veprimtarisë 2017-2022 (viti i ndryshimeve ligjore dhe shfuqizimit të pikës 4 të nenit 29), në 55 raste të verifikimit të zyrtarëve, Autoriteti ka trajtuar gjatë procesit të vendimmarrjes, administrimin ose jo, të kërkesës për verifikim, në varësi të disponimit ose jo, të dokumentit autentik original, të certifikatës së pastërtisë së figurës, nga Mezini Bezhani.

Nga 55 rastet në total, gjatë viteve 2017-2022, janë marrë 17 vendime për mosadministrimin e kërkesës për verifikim, sepse disponohej certifikata autentike e pastërtisë nga institucionet përgjegjëse (komisionet Mezini dhe Bezhani), pra Autoriteti, nuk mund të kryente verifikim, kur ishte dhënë certifikata e pastërtisë.

Por ndër to, në 9 raste të konstatuara përmes proceseve paralele ose 16.3% e tyre, u gjetën rastësisht, të dhëna që e lidhnin figurën e zyrtarit me strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit. Zbatimi i dispozitës neni 29 pika 4 e ligjit nr. 45/2015, bënte që Autoriteti të shprehej me dy vendimmarrje të ndryshme, për të njëjtin subjekt, ku në një procedurë rezultonte si bashkëpunëtor i ish-sigurimit të shtetit, apo anëtar i ish-Sigurimit, hetues ose gjyqtar, ndërsa në procedurën tjetër, subjekti zotëronte certifikatën e pastërtisë së figurës së tij dhe nuk mund të verifikohet.

Përmes shfuqizimit të plotë të pikës 4 në nenin 29 të ligjit, ka rënë barriera ligjore. Zyrtarët nuk janë më të mbrojtur ligjërisht, nga kjo dispozitë.

Së pari: Autoriteti ka identifikuar rastet dhe institucionet ku vendimmarrja e Autoritetit lidhet me kandidatë që dispononin dokumentin autentik original (ose kopje) të certifikatës së pastërtisë së figurës e si rrjedhim, të paverifikuar nga Autoriteti, për shkak të pengesës ligjore.

Së dyti: në mbështetje të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, I) ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, II) ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, III) ligjit nr. 105/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, IV) ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” dhe në funksion të zbatimit të plotë të detyrimeve ligjore që kanë institucionet shtetërore në Republikën e Shqipërisë, me shpresë ka kërkuar bashkëpunimin e institucioneve të mësipërme, me qëllim që lidhur me vendimmarrje të tilla të mëparshme, t’i drejtohen Autoritetit me kërkesë për riverifikimin e figurës së zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie të figurës, të komisioneve “Mezini” dhe “Bezhani”.

Vetëm një institucion është angazhuar për të bashkëpunuar në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë. Me këtë institucion, po vijon komunikimi zyrtar.

c. Të vijojë punën me ndërtimin e të dhënave të detajuara, për personat e zhdukur, që do të shërbejë si Regjistri i Personave të Zhdukur, për nisjen e

procesit të identifikimit dhe rikuperimit, si dhe për krijimin e databazës së ADN-së, së të afërmeve të personave të zhdukur.

AIDSSH, kryen pranimin, regjistrimin dhe studimin e kërkesave të familjarëve dhe të afërmeve të personave të zhdukur, për qartësimin e fatit të këtyre të fundit. Gjithashtu, në vijim do të fillojë puna për krijimin e një tjetër baze të dhënash, me emrat e trashëgimtarëve të parë dhe të dytë (sipas rastit), me synim që bashkë me ICMP-në, apo ndonjë institucion tjetër, si Instituti i Policisë Shkencore, të krijojmë një baze të tretë, me të dhënat e profileve gjenetike të eshtrave që do gjenden gjatë procesit dhe të trashëgimtarëve të parë, apo të dytë, të të zhdukurve.

AIDSSH në bashkëpunim me Zyrën e ICMP-së në Tiranë dhe duke u nisur nga përvoja në Qendrën e Kërkimit Online dhe Sistemin e Integruar të Menaxhimit të të Dhënave, ka filluar punën për krijimin e një baze të vetme të dhënash, për personat e zhdukur, të aksesueshme nga publiku, ku do përfshihen të dhënat që ndodhen pranë AIDSSH, si më poshtë:

1. Regjistrin e të Zhdukurve me të dhëna mbi gjeneralitetet, rrethanat e heqjes së lirisë, vendin arrestimit, rrëmbimit ose burgimit, kohën dhe vendin e dyshuar të zhdukjes apo ekzekutimit dhe që plotësohen me informacione që Autoriteti mund të mbledhë rreth këtyre të fundit, të dhëna rreth familjarëve dhe të afërmeve të personave të zhdukur.
2. Hartën e vendvarrimeve, apo vendekzekutimeve, të identifikuara apo të dyshuara, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me të dhëna dhe informacione të mbledhura përmes hetimive administrative së pari, po edhe nga dokumente të institucioneve që kanë lidhje me procesin; familjarë, apo të afërm të personave të zhdukur, apo ekzekutuar dhe nga të tretë.

d. Të vijojë me informimin e studiuesve dhe medieve të interesuara për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimin e dublikatave të tyre të kërkuesi, brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit organik 45/2015, i ndryshuar.

Për vitin 2023, janë administruar 112 kërkesa studimore dhe mediatike, janë miratuar 116 vendime të Autoritetit (përfshirë edhe ato të mbartura nga viti 2022), për 1329 dosje, me një total prej 138 010 faqesh, ndër të cilat, janë anonimizuar material dokumentar, me një total prej 10 522 faqesh.³

Janë trajtuar kërkesa të mbartura dhe kërkesat e reja, të paraqitura gjatë kësaj periudhe. Me ndryshimet ligjore të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, është bërë e mundur shkurtimi i afateve kohore të trajtimit të kërkesave studimore dhe mediatike, për shkak të mundësisë së konsultimit të dokumenteve të identifikuara. Duke shfrytëzuar informacionet dhe dokumentat në Arkivë, ato që disponohen në fushën e informimit, si dhe në fushën e

³ Një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve të vëna në dispozicion, kanë qenë të anonimizuara më herët, për kërkesa të studiuesve/medieve të mëparshëm.

mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar, është koordinuar procesi, janë identifikuar dhe kthyer përgjigje për kërkesat studimore/mediatike.

e. Të sistemojë dhe të vijojë me procesin e digjitalizimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të mbledhura nga institucionet arkivore në vend, në arkivin e vetëm të Autoritetit.

Autoriteti, ka realizuar procedurën e prokurimit me objekt “Skanim të dokumenteve arkivore” Marrëveshje Kuadër për 24 muaj, për skanimin/digjitalizimin 3.000.000 fletë.

Është kryer skanimi i dokumenteve arkivore me Operatorin ekonomik “ALFA SERVICES” Shpk, bazuar në kontratën nr.1051/28 prot., si dhe planin e zbatimit të kontratës 1051/29 prot, me objekt “Skanim të dokumenteve arkivore”. Me Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës, që ka mbikëqyrur të gjithë procesin. Në dhjetor të vitit 2023, ka përfunduar zbatimi i kontratës së parë, duke u skanuar 1.419.597 imazhe dhe bazuar në marrëveshjen kuadër të lidhur në vitin 2023, për skanimin e dokumenteve arkivore, jemi në përgatitjen e dokumentacionit arkivor për fazën e dytë, që pritet të përfundojë në vitin 2024.

Procesi i skanimit është mbikëqyrur nga stafi i Autoritetit (Arkivit) nëpërmjet identifikimit, vënies në dispozicion të dokumenteve arkivore, si dhe ndjekjes të të gjithë procedurës ligjore për këtë proces.

f. Të përmirësojë procedurat e brendshme për trajtimin e kërkesave individuale, institucionale, studimore dhe qytetare, me qëllim shkurtimin e afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit.

Autoriteti ka realizuar Mini-internship i një grupi pune nga Autoriteti, pranë STASI-t (STASI Records Archive), Berlin, 15-17 Nëntor 2023, me trajnimin rreth çështjeve: Kartoteka-rregullorja operative, inventari, përgatitja, kategorizimi dhe administrimi i kartave dhe dhënia e shërbimit; Procesi i zhbllokimit (dekodifikimit) - rregullat e përgjithshme, hapat për identifikimin e bashkëpunëtorëve, rrjedha e procesit; Mediateka - Rregullat e përgjithshme, tipologjia e dokumentave, operimi dhe administrimi i sistemit; Arkiva digjitale - administrimi, nivelet e ndryshme të sigurisë, për lloje të ndryshme të përdoruesve, operimi dhe problematika të mundshme që lidhen me mirëmbajtjen.

Në përfundim të këtij trajnimi, në mini-intershipin pranë STASI-t (STASI Records Archive), Autoriteti vlerësoi njohuritë e fituara në çështjet e trajtuara. Në frymën e kësaj eksperience të vlefshme, Autoriteti ka filluar punën ***për krijimin e kartotekës***, që pritet të përfundojë në 2024; ***janë hedhur idetë për mediatekën***, si dhe po ***përgatiten draftet e udhëzuesve të ndryshëm në funksion të përmirësimit të punës për trajtimin e kërkesave***.

Rishikimi i akteve nënligjore do të përmirësojë trajtimin e kërkesave individuale, studimore dhe qytetare, me qëllim shkurtimin e afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit. Është hartuar draft-udhëzuesi i trajtimit të kërkesave për zbardhjen e bashkëpunëtorëve, draft që

është konsultuar dhe në nivel kolegjal, dhe pritet të miratohet me vendim kolegjal, në fillim të vitit 2024

Autoriteti, ka realizuar procedurat për plotësimin e organikës për vendet vakante, për disa drejtori dhe ky plotësim, pritet të sjellë rezultate pozitive në shkurtimin e kohës së trajtimit të kërkesave pranë Autoritetit.

.

- g. Të bashkëpunojë me Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri dhe t'i krijojë lehtësira në punën për të përmbushur detyrimet që burojnë nga neni 5, i ligjit nr. 10242, 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, në masën dhe për qëllimet që lejon neni 26 i ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.**

Në vijim të detyrave të lëna nga Rezoluta, Drejtorja e Arkivit ka trajtuar me përparësi, 2 studiuesit e ISKK-së, për vitin 2023, duke u vënë në dispozicion sipas procedurave, 70 njësi arkivore.

Autoriteti, ka realizuar takimin më datë 21.09.2023, me ISKK-në, në kuadër të rakordimit të agjendave dhe mbarëvajtjes së punës në nivel drejtuesish dhe sekretariati teknik të të dy institucioneve, si dhe bisedimeve lidhur me interesin dypalësh për bashkëpunimin ndërinstitutional nëpërmjet rishikimit dhe zgjerimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Autoritetit dhe ISKK-së. Në vijim më datën 12.10.2023, është realizuar vizitë pranë Autoritetit të delegacionit nga ISKK dhe homologut rumun (IICCMER + ISCCC), vizita është finalizuar me njohjen e Arkivit, tipologjinë e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, metodën e punës, me procedurat e ndjekura në kthimin e përgjigjeve, si dhe veprimtarinë e përditshme të Autoritetit.

Në vitin 2023 është shqyrtuar dhe miratuar në parim, draft-marrëveshja e bashkëpunimit, që është dërguar për njohje, sugjerime dhe dakordësi pranë ISKK-së.

- j. Të bëjë transparencën e vendimmarrjes në raportimin vjetor, ku të pasqyrohet mendimi kundër në rastet e vendimmarrjes jo unanime.**

Është bërë publikimi në mënyrë të vazhdueshme, në kuadër të programit të transparences të vendimmarrjes së Autoritet, si dhe Buletinet dhe aktet nënligjore, marrëveshjet e bashkëpunimit;

AIDSSH, në bashkëpunim me Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka zbatuar programin e transparences konform rregullave, si dhe është kryer hedhja e të dhënave përkatëse në seksionin e transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit.

5. VEPRIMTARIA E AUTORITETIT PËR VITIN 2023

1.1. ARKIVI

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 45, datë 30.04.2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti ka krijuar arkivin për mbledhjen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit. Ky arkiv organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit – miratuar me Vendim të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 21, datë 09.05.2017, i ndryshuar, ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, (i shfuqizuar), ligji nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar”, ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor të Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatimin e ligjeve të sipërcituara.

Ruajtja dhe shërbimi i dokumenteve arkivore

Ruajtja dhe mirëmbajtja e materialeve arkivore të grumbulluara, duke garantuar se dokumentet, nuk do të lexohen, kopjohen, ndryshohen, asgjësohen, apo largohen pa autorizim, është një nga detyrat kryesore funksionale të Autoritetit. Kjo detyrë është ndjekur dhe zbatuar në të gjitha ambientet ku ruhen dhe administrohen dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, të marra në dorëzim nga Autoriteti. Theksojme faktin se, në vitin 2023, i gjithë dokumenacioni arkivor, që sipas ligjit 45/2015 parashikohet të administrohet nga Autoriteti, **është depozituar dhe administrohet në ambiente të sigurt dhe me standarde ruajtjeje sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin për Arkivat.**

Për përmbushjen me sukses të kësaj detyre, strukturat përkatëse, në zbatim të rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi:

1. Kanë respektuar me rigorozitet protokollin e hyrje-daljeve në mjediset e arkivit, që përfshin regjistrimin në regjistra, datën, orën, qëllimin e hyrjes dhe nënshkrimin, dhe autorizimin përkatës nisur nga fakti që, vetëm personat e autorizuar mund të lejohen, të hyjnë në arkivë.
2. Kanë kryer procedurat e hapjes, ajrosjes dhe kontrollit të ambienteve ku ruhen dokumentet, në mënyrë periodike;
3. Kanë respektuar skemat e vendosjes fizike të dokumenteve arkivore gjatë përdorimit të tyre, me qëllim ruajtjen e kohezionit arkivor;
4. Kanë marrë masat e duhura që të kryhet procedura e dezinfektimit dhe deratizimit të sallave të arkivit sipas parashikimeve të Normave tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivore në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e dokumenteve arkivore nga dëmtimet që mund të vijnë nga prania e mikroorganizmave;
5. Në mënyrë të vashdueshme është treguar kujdes në përdorimin e dokumenteve arkivore, në mënyrë të veçantë, dokumentet e vjetra dhe shumë të vjetra.

Shërbimi i dokumenteve arkivore për qëllime dhe sipas kërkesave të miratuara në Autoritet, si dhe digjitalizimi i tyre për informimin e qytetarëve, studiuesve/medias dhe institucioneve është realizuar në përputhje të plotë me Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, ligjit “Për arkivat”, Normat Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë për dokumente arkivore që nuk përmbajnë informacion të klasifikuar dhe sipas dispozitave të ligjit nr. 10, datë 02.02.2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre. Pjesë e këtyre procedurave është numërimi fletë për fletë, si dhe dhënia e tyre për shfrytëzim.

Trajtimi i kërkesave


Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar neni 44, pika 4 dhe 5, është përmirësuar puna dhe efektiviteti në dhënien e shërbimeve subjekteve kërkuese, pasi kërkesat shqyrtohen në një afat kohor më të shkurtër, për shkak të deklasifikimit *ex lege* të dokumentacionit arkivor me nivel klasifikimi.

Ndryshimet ligjore të pikës 5, të nenit 44, parashikojnë mundësinë e riklasifikimit kur gjykohet se çënohet siguria kombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Por, ligji për informacionin e klasifikuar parashikon qartë se, riklasifikimi bëhet vetëm nga autoriteti që ka krijuar informacionin e klasifikuar. Dokumentacioni arkivor që administron Autoriteti është dokumentacion i trashëguar dhe jo i krijuar nga Autoriteti, gjë e cila, e bën të pamundur riklasifikimin e tij. Për këtë arsye, Autoriteti është në kushtet e zbatimit të nenit 6, të ligjit nr. 45/2015, që parashikon kufizimin e përdorimit të të dhënave të dokumenteve që çënojnë sigurinë kombëtare.

Deklasifikimi i dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”

Një tjetër proces pune shumë i rëndësishëm, që kryhet nga Drejtoria e Arkivit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, është edhe përgatitja e praktikave të plota, për mbledhjet e KDZH-së.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, janë hartuar relacionet për propozim deklasifikimi, janë zhvilluar **19** mbledhje të KDZH-së dhe janë marrë **21** Vendime, në bazë të të cilave janë deklasifikuar **5 591** njësi arkivore (dosje, fashikuj etj.) me një total prej **237 259** fletë dokumente arkivore, sikurse është ilustruar më poshtë:



Grafiku nr.2: Paraqitja në formë grafike e ecurisë së vendimeve të KDZH Janar-Dhjetor 2023

Bibliografitë e dokumenteve të deklasifikuara i janë dërguar “Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ) për publikim në fletoren zyrtare, si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AIDSSH-së.

Digjitalizimi i dokumenteve

Gjatë vitit 2023, janë digjitalizuar **2113** dosje fizike dhe **175** dosje të mikrofilmuara, me një total prej **158 268** faqe dokumente arkivore, sikurse janë pasqyruar më poshtë.

Të gjitha dokumentet e digjitalizuara, janë regjistruar në pajisjen e ruajtjes (serverin) dhe regjistrin elektronik përkatës.

Përveç digjitalizimit, janë përgatitur dhe vënë në dispozicion CD me dokumentet e anonimizuara nga Drejtoria e Informacionit dhe Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Edukimit Qytetar. Pas kryerjes së procesit të anonimizimit nga sektorët përkatës, Sektori i Digjitalizimit ka kryer procedurat e arkivimit në server, të dokumenteve të anonimizuara dhe ka përgatitur (djegur) 285 CD, për vënien në dispozicion të kërkuësve.

Nr.	Numri i dosjeve	Numri i faqeve
Dosje fizike	2 113 dosje	154478
Pergatitur(djegur)	285 CD	
Fotokpjuar		3790
Totali	2 113 dosje fizike	158 268

Tabela nr.1: Paraqitja në formë tabelare e dokumenteve të digjitalizuar janar- dhjetor 2023

Gjithashtu, në zbatim të Vendimit nr. 406 datë 13.9.2021 të Autoritetit për “Projektin e digjitalizimit të regjistrave të përpunimit, regjistrave të internim/ dëbimeve, si dhe Vendimeve të Komisionit Qendror të Internim Dëbimeve, ka përfunduar skanimi i të gjithë regjistrave të përpunimit.

Skanimi i dokumentave arkivore.

Gjatë vitit 2023 është mundësuar finalizimi i planit (softit) të Arkives Digjitale të financuar nga Qeveria Suedeze, në kuadrin e projektit “ Prokurimi i rikonstruksionit të Ndërtesës së Autoritetit dhe Shërbimeve të TIK, për ngritjen e një arkivi të integruar e modern”, nëpërmjet të cilit, do të mundësohet lehtësimi dhe shpejtimi i punës për kërkimin e dokumenteve arkivore dhe njëkohësisht, kërkimi në brendësi të materialeve. Në këtë kuadër, për të realizuar popullimin e programit (softit) me të dhëna, si dhe për të mundësuar përsheptimin e punës së kërkimit të informacionit dhe vënien në shërbim të qytetarëve, studiuesve, si dhe institucioneve të interesuara, u punua intesivisht për skanimin e dokumenteve arkivore.

Në total janë skanuar 1.419.597 imazhe, kjo realizuar nga një kompani e specializuar në këtë fushë. Nga ana e autoritetit është punuar në mënyrë konsistente në përgatitjen e dokumenteve për skanim, si dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme, të parashikuara në ligjislacionin në fuqi, në këtë rast. Një fond i konsiderueshëm dokumentesh, është parashikuar që të skanohen në vitin 2024.

1.2. INFORMIMI I INDIVIDEVE DHE QYTETAREVE

Gjatë vitit 2023, është punuar për përmbushjen e objektivave të Autoritetit në kuadër të krijimit të lehtësirave në procedurat e kërkesave të qytetarëve, për:

- verifikimin e zyrtarëve që konkurrojnë për t’u zgjedhur ose emëruar në detyra publike;
- informimin e individëve, mbi dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit;
- informimin në kuadër të dekorimit të shtetasve dhe të emërimit të hapësirave publike me emra personalitetesh;
- përmbushjen në kohë dhe me cilësi, të detyrave funksionale dhe ndihmëse në funksion të nevojave e prioriteteve;

Ndërmjet të tjerash, objekti dhe qëllimi kryesor i veprimtarisë së Autoritetit është, të sigurojë të drejtën e çdo qytetari, për të parë informacionin e krijuar ose të mbledhur rreth tyre, nga ish-Sigurimi i Shtetit. Sipas ligjit, të afërmit (trashëgimtarët) mund të shikojnë edhe dosjet e një anëtarit të familjes që nuk jeton, sipas rendit ligjor të trashëgimisë, vetë ose duke pajisur me prokurë një person tjetër. Qytetarët do të jenë në gjendje, të fitojnë qasje në këto dosje, pas dorëzimit të një kërkesë pranë Autoritetit dhe që duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar ligjor. Gjithnjë në përputhje dhe respektim të dispozitave në fuqi, për të mbrojtur të drejtën e privatësisë së çdo pale të tretë dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut

dhe dinjitetin e të gjithë personave. Ofrimi i aksesit sa më parë, në këto dokumente, mbetet prioritet i Autoritetit.

Kërkesa individuale

Gjatë kësaj periudhe është punuar në procesin e përmirësimit e përpunimit të mëtejshëm, si dhe sqarimit e ndihmës në lidhje me formularët e kërkesave për informim nga individët dhe ata mbi vendin e vuajtjes së dënimit dhe internim-dëbimet për efekt pensioni. Janë hartuar dhe miratuar formularët mbi të pagjeturit në përshtatje me udhëzuesin përkatës dhe ndryshimet ligjore në përmbushje të detyrave që dalin nga rezoluta e kuvendit.

Në periudhën 12-mujore, janar – dhjetor 2023, në gjuhën e shifrave rezulton, se:

- Janë paraqitur në Autoritet **457** kërkesa individuale;
- Janë legjitimuar **432** kërkesa individuale, nga këto **11** kërkesa janë te 2022;
- Janë mbyllur **509** kërkesa individuale janë marre **471** vendime, nga të cilat:
 - **277** kërkesa me dokumentacion arkivor;
 - **187** kërkesa pa dokumentacion arkivor;
 - **10** kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh;
 - **27** kërkesa kthim përgjigje
- Janë ndjekur me prioritet dhe përfunduar **179** kërkesa të mbartura nga viti 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nga të cilat:
 - **136** kërkesa me dokumentacion arkivor;
 - **28** kërkesa pa dokumentacion arkivor;
 - **10** kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh;
 - **4** kthim përgjigje;
 - **1** nuk është legjitimuar
- Gjatë vitit 2023 u janë dorëzuar qytetarëve, **252** kërkesa me vendimet dhe fletët e anonimizuara dhe të digjitalizuara, me një volum prej rreth **67.000** faqesh;
- Përgjatë vitit 2023, është bërë përpunimi i më shumë se **98.000** faqeve, nga të cilat, **27.000** faqe janë të anonimizuara.

Viti	Nr. i kërkesave të mbërritura	Të përfunduara		Kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh
2023		Me të dhëna arkivore	Pa të dhëna arkivore	
	457	277	187	10

Në ushtrim të detyrës është punuar me prioritet, në kuadër të procesit të mbrojtjes të të dhënave gjatë përpunimit dhe dhënies së informacionit, në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe zbatimi i përpiktë i ligjit nr. 9887/2008

“Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën për Informim”, krahas garantimit të integritetit të procesit në përgjithësi në dhënien e informacionit, duke e bërë këtë të fundit, lehtësisht të aksesueshëm, të saktë dhe të plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.

Në vlerësimin tonë dhe perceptimin publik të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH” i ndryshuar, qëllimi përcaktues dhe detyra prioritare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është dhe për një kohë të gjatë, do të mbetet, marrja në shqyrtim e kërkesave të paraqitura nga individët.

Kërkesa individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi

Gjatë vitit 2023, janë paraqitur pranë Autoritetit, **176** kërkesa për internim-dëbim ose burgim, nga të cilat:

- **59** kërkesa për internim/dëbimet nga ISSh-të e rretheve
- **113** kërkesa për internim/dëbimet nga qytetarë;
- **4** kërkesa për informim nga institucionet;;

Autoriteti trajton kërkesa për vërtetim të periudhës së internimit, mbështetur në ligjin 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në bazë të Vendimit nr. 91, datë 04.03.2019 të Autoritetit.

Gjatë trajtimit të kërkesave për periudhën e internimit, jemi ndeshur me faktin që një numër i konsiderueshëm i kërkesave, vijnë nga persona që kanë lindur në internim ose janë internuar kur kanë qenë minorenë, së bashku me familjarët e tyre. Problematika e hasur në lidhje me këto kërkesa është fakti se, për këta persona, nuk gjenden të dhëna arkivore, pasi Komisioni i Internim-Dëbimit, nuk merrte vendime për të lindurit në internim dhe minorenët. Nisur nga ky fakt, Autoriteti ka dalë me përgjigje negative për këtë kategori personash dhe për këtë arsye, ata nuk mund ta përfitojnë shtesën e pensionit, për periudhën e internimit që kanë kryer.

Për sa i përket personave, të cilët, kanë qenë minorenë, në kohën e internimit të tyre, Komisioni i Internim-Dëbimit, nuk merrte vendime për ta, si subjekte, që do të thotë se Autoriteti, nuk e ka të mundur, të gjejë të dhëna arkivore për këtë kategori subjektesh e për rrjedhojë, nuk mundet t’u kthejë përgjigje lidhur me kërkesat e tyre. Duke marrë në konsideratë gjithë sa më sipër, lidhur me subjektet që ligji i parashikon si të përshtatshëm për të përfituar dëmshpërblime financiare, do të ishte me vend që, në objektin e ligjit përcaktuar në nenin 1 të tij, të përfshiheshin edhe personat të cilët, kanë qenë minorenë, duke vërtetuar lidhjet faktike me praninë e tyre në kampet e internimit, duke qenë se, pa dyshim, kjo periudhë ka shenjuar edhe jetën e tyre, dhe si e tillë, duhet t’i nënshtrohet trajtimit me dëmshpërblimin përkatës. Kjo gjë mund të arrihet, vetëm duke e parashikuar kushtin e

vendosur për vërtetimin e periudhës së internimit, me dokumente të krijuara si burime arkivore, përpara datës 1.10.1991, në nenin 1 të ligjit, si një kusht alternativ dhe jo shterues.

Viti	Ardhur	Mbyllur
2017	95	65
2018	184	115
2019	135	153
2020	118	99
2021	344	295
2022	295	290
2023	176	169
Totali	1347	1189

Për arsye se, në dosjet hetimore-gjyqësore nuk gjenden të dhëna për numrin e repartit ku të burgosurit kanë kryer dënimin, në bashkëpunim me sektorin e kërkesave individuale për dosje të identifikuar më parë (nga trajtimi i kërkesës individuale që kërkesi ka bërë) është bërë i mundur identifikimi i materialeve nga dosjet e përpunimit, ku cilësohet vendi i kryerjes së dënimit, për të burgosurin.

1.3 Kërkesa për Verifikimin e Figurave

Edhe gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2023, disa nga organet e pushtetit vendor kanë vlerësuar zbatimin korrekt të ligjit nga ana e Autoritetit dhe kanë bashkëpunuar me Autoritetin, për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim dhe propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.

Për vitin 2023, vetëm 10 (dhjetë) bashki, nga 61 prej tyre, kanë paraqitur 23 kërkesa për verifikimin e pastërtisë së figures, të 41 shtetasve të propozuar, për 1 kandidat për emërim, ngritje në detyrë dhe 40 kandidatë, në kuadër të dhënies së titujve vendorë të nderit: “Qytetar Nderi”, apo të propozuara për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik, nga ana e Bashkive. Janë mbyllur procedurat e verifikimit, për 61 shtetas (disa raste janë të mbartura nga viti 2022). Mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti, vetëm për 10 (dhjetë) kandidatë (gjithsej janë 14, shtetasit që figurojnë për vitin 2023), për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik, apo dekorim e tituj nderi kanë rezultuar dokumente të ish-sigurimit të shtetit në emër të tij, ku të dhjetë figurojnë si Bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit, apo dëshmitarë.

Përveç kërkesave të pushtetit vendor, për verifikim të kandidatëve për emërtimin e disa hapësirave të territorit publik, apo dekorim të shtetasve, Autoriteti gjatë vitit të punës ka kryer brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësimin e cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe atyre për t’u zgjedhur në / nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria, institucioni i Presidentit të Republikës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme, Avokati i Popullit për verifikimin e kandidatëve për Komisioner

pranë Avokatit të Popullit dhe për anëtar të KLP dhe KLGJ, si dhe kërkesat për verifikimin e kandidatëve për Avokat i Popullit, Departamenti i Administratës Publike, ERE dhe institucioneve të tjera të paraqitura.

Në total, për periudhën janar – dhjetor 2023, pranë Autoritetit janë paraqitur 124 kërkesa për verifikimin e 232 zyrtarëve, janë verifikuar 257 kandidatë, nga të cilët, vetëm për 14 kandidatë rezultojnë me dokumente, pra figurojnë në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, si bashkëpunëtorë, anëtarë të ish-Sigurimit të Shtetit, si Prokurorë dhe dëshmitarë në procese politike dhe nga Autoriteti, janë marrë 91 vendime.

Për 10 zyrtarë të tjerë, është vendosur moslegjitimimi i kërkesës për verifikim, për 1 zyrtar është ndërprerë verifikimi me kërkesë nga institucioni, ndërsa për një zyrtar tjetër është vendosur pezullimi për kryerjen e verifikimit, në referencë të kërkesës së vetë institucioneve kërkuese.

Viti	Nr. i kërkesave	Kandidatë të verifikuar	Kandidatë pa të dhëna	Figurojnë në dokumente	Vendime
2022	65	214	204	6	81
2023	124	232	243	14	91

Në raport me të njëjtën periudhë njëvjeçare raportimi, për vitin 2023 ka një rritje në numrin e kandidatëve për verifikim, gjithsej 232 nga 214 të paraqitur në vitin 2022, afërsisht +8.41%. Gjithashtu janë verifikuar 257, nga 210 kandidatë të verifikuar në vitin 2022; pra, për vitin 2023, kemi më shumë kandidatë të verifikuar se në vitin 2022, afërsisht 22.4%. 9 kandidatë kanë rezultuar me probleme, krahasuar me vitin 2022, ku rezultojnë 6 kandidatë, afërsisht 50% më shumë.

Pranë Autoritetit, gjatë periudhës janar – dhjetor, janë paraqitur katër kërkesa me iniciativë personale për verifikim, nga deputetë në detyrë të Kuvendit të Shqipërisë.

Me rastin e zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023, Autoriteti ka bashkëpunuar me të gjitha partitë politike të regjistruara në zgjedhje, që të merrnin në konsideratë këtë proces të rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve, duke përcjellë shkresat, së bashku me formularët. Pranë Autoritetit, janë paraqitur vetëm dy kërkesa: një, nga kandidati për Këshillin Bashkiak Vlorë, propozuar nga subjekti politik *Partia Demokratike* dhe tjetra, nga kandidati për Këshillin Bashkiak Krujë.

Vijon të mbetet problematikë, mungesa e bashkëpunimit nga ana e subjekteve politike, që çon në moszbatimin e detyrave ligjore të ngarkuara sipas përcaktimeve të nenit 30 të ligjit.

Paketa me propozime për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor, do të krijojë hapësirën ligjore që të kryhet verifikimi i gjithë kandidatëve që kandidojnë në zgjedhje.

Po kështu, si pjesë e paketës me ndryshime ligjore pritet të propozohet regullimi lidhur me procesin e integritetit të zyrtarëve që emërohen apo zgjidhen në detyrë përmes vetdeklarimit.

Në vitin 2022, ligji funksional nr. 45/2015, pësoi ndryshime dhe shtesa në dispozita të veçanta të tij.

Një ndryshim ligjor shumë i rëndësishëm ishte shfuqizimi i nenit 29, pika 4 e ligjit nr. 45/2015, që parashikonte se “Autoriteti nuk administron kërkesat për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike kur ata kanë marrë certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.

Pas ndryshimeve ligjore dhe interesit të lartë të publikut, për mënyrën si është kryer verifikimi i figurave nga këto komisione, u miratua ngritja e Grupit të Punës me objekt “Identifikimin dhe njohjen e akteve juridike dhe veprimtarinë e dy institucioneve përgjegjëse, lidhur me procesin e kontrollit të figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë në Republikën e Shqipërisë, listës me bazë të dhënash të dokumentacionit arkivor të krijuar, numrin e zyrtarëve të verifikuar prej tyre dhe rezultatin e verifikimit, procesin e grumbullimit, marrjes në administrim dhe përpunimit të fondit dhe praktikat ndërkombëtare për verifikimin e figurave”.

Në përfundim të punës, Grupi i Punës ka hartuar raportin përmbledhës me 62 faqe, me nivel klasifikimi, ku është identifikuar dhe pasqyruar informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga dokumentacioni arkivor, i krijuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse të përfshira në procesin e kontrollit të figurës të subjekteve të verifikuara. Raporti është miratuar me Vendim të Autoritetit. Kopje e raportit është dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2022”, në pikën 2 rekomandohet që “Pas ndryshimeve ligjore që sollën shfuqizimin e komisioneve “Bezhani” dhe “Mezini”, Autoriteti të bashkëpunojë me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, me qëllim që t’i drejtohen Autoritetit, me kërkesë për **riverifikimin e figurës** së zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie”.

Për periudhën e veprimtarisë 2017-2022 (viti i ndryshimeve ligjore dhe shfuqizimit të pikës 4 të nenit 29), rezulton, se **në 55 raste** të verifikimit të zyrtarëve, Autoriteti ka trajtuar gjatë procesit të vendimmarrjes, administrimin ose jo të kërkesës për verifikim, në varësi të disponimit ose jo të dokumentit autentik original, të certifikatës së pastërtisë së figures, nga “Mezini”, “Bezhani”.

Nga 55 rastet në total, gjatë viteve 2017-2022 janë marrë 17 vendime, për mosadministrimin e kërkesës për verifikim sepse disponohej certifikata autentike e pastërtisë, nga institucionet përgjegjëse (komisionet “Mezini” dhe “Bezhani”).

Për ato institucione për të cilat, gjatë veprimtarisë së ushtruar, Autoriteti kishte pengesë ligjore për të administruar kërkesën për verifikim, pasi kandidatët dispononin dokumentin autentik origjinal (ose kopje) të certifikatës së pastërtisë së figures, ka informuar dhe kërkuar bashkëpunimin e institucioneve ku janë përcjellë këto vendime të mëparshme, për mosadministrimin e kërkesës për verifikim, që t'i drejtohen Autoritetit, me kërkesë për **ri-verifikimin e figurës** së zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie të figures, të komisioneve “Mezini” dhe “Bezhani”.

1.3.MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS

Lidhur me temën e të zhdukurve gjatë regjimit komunist, në vitin 2022, ka pasur zhvillime të rëndësishme. Në kuadër të ndryshimeve të fundit në ligjin 45/2015, si pjesë e Autoritetit, u krijua Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, një strukturë që është përgjegjëse për komunikimin administrativ ndërmjet institucioneve përgjegjëse që janë të përfshira në proces. Kjo drejtori do të ketë si fushë veprimi bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe marrjen e masave për ruajtjen e vendvarrimeve, duke plotësuar çdo komunikim institucional të Autoritetit me institucionet përgjegjëse, ndjekjen e projekteve të dedikuara, duke krijuar kështu një tablo të qartë të të gjithë veprimtarisë për të pagjeturit, përfshirë edhe aktorët e tjerë në këto procese, sa delikate, aq edhe humane.

Kërkesat e mbërritura për personat e zhdukur

Gjatë vitit 2023, aspekt i rëndësishëm i punës së Drejtorisë së Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur, ka qenë administrimi i kërkesave për personat e zhdukur, të paraqitura nga familjarë dhe të afërm të të zhdukurve gjatë regjimit komunist, ku njëherazi atyre u është bërë me dije se mund të japin dëshmi/rrëfime etj., në funksion të saktësisimit të të dhënave dhe mbledhjes së informacionit për qartësimin e fatit të të zhdukurve. Autoriteti, në bashkëpunim me ICMP-në është në proces për standardizimin e rekomandimit të familjarëve të të zhdukurve, për dhënien e ADN-së në funksion të procesit.

Gjatë periudhës së raportimit, nga të afërm të personave të zhdukur, janë depozituar; 57 kërkesa, nga të cilat, 39 kërkesa rezultojnë me të dhëna arkivore, ndërsa 9 kërkesa, pa të dhëna;

Në aspektin gjinor, nga personat kërkues në vitin 2023, 8 kërkuese janë të gjinisë femërore, ndërkohë nga personat e identifikuar, 1 rast personi i zhdukur, është femër.

Në lidhje me vendndodhjen, janë hasur vështirësi dhe ka mungesë informacioni, për ekzistencën e vendvarrimeve të dyshuara. Vendndodhje, për të cilat ka të dhëna për më tepër se një rast, janë territori i burgut të Burrelit, burgu i Gjirokastrës, burgu i Shkodrës dhe Kampi i Tepelenës, Zona e Spacit, Rehova etj.

Në lidhje me sa më sipër dhe shfrytëzimin e mjeteve në dispozicion në kuadër të bashkëpunimit edhe me institucionet e tjera, i janë drejtuar 53 kërkesa, Ministrisë së Brendshme, në përgjigje të të cilave, për 3 kërkesa kemi pasur përgjigje me të dhëna arkivore, ndërsa për 50 kërkesa, nuk është bërë e mundur që të gjenden të dhëna arkivore. Po kështu janë dërguar 53 kërkesa, për kërkim dokumentacioni Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku vetëm për 4 kërkesa është bërë e mundur gjetja e të dhënave. Në total pranë Autoritetit, për periudhën 2017- 2023, janë regjistruar 280 kërkesa që kanë të bëjnë me qartësimin e fatit të të zhdukurve.

Procesi e miratimit të VKM-së, si dhe bashkëpunimi ndërinstitutional

Në zbatim të nenit 22/1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në vitin 2022 Autoriteti, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë, punoi për hartimin e draft-VKM-së: “Për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të personave të zhdukur në këtë periudhë”.

Siç kemi raportuar një vit më parë, sfidë mbetet realizimi i kuadrit të plotë ligjor që përcakton përgjegjësitë dhe modalitetet e palëve me rol në proces, ku Vendimi i Këshillit të Ministrave, i cituar më lart, është parësor dhe mund t’i bënte më të nevojshme, më konkrete dhe të zbatueshme edhe marrëveshjet dy ose më shumëpalëshe të lidhura, ose që do të lidhen mes institucioneve të përfshira në procesin për identifikimin dhe rikuperimin e personave të zhdukur.

Lidhur me VKM-në e mësipërme, edhe në vitin 2023 është vijuar me tryezat e zgjeruara, me pjesëmarrjen e Autoritetit dhe institucioneve vendase dhe të huaja, prezencës së OSBE-së, së pari, të përfaqësuesve të Prokurorisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Zyrës së ICMP-së Tiranë, Institutit të Mjekësisë Ligjore, Institutit të Policisë Shkencore e në ndonjë rast edhe përfaqësues nga Ministria për Reformat Ligjore dhe Marrëdhëniet me Parlamentin.

Si rezultat i takimeve është arritur dakordësimi mes palëve, lidhur me (I) Rolin nismëtar dhe koordinues që duhet të luajë Autoriteti në të gjithë procesin e kërimit, gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të të zhdukurve, deri në nderimet dhe ngritjen e memorialeve për nder të tyre; (II) Natyrën administrative të procesit të gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve; (III) - Fillimi i gërmimeve do të jetë një proces i dakordësuar së pari, mes Autoritetit, Pushtetit vendor (Bashkive), pas miratimit nga Policia e Shtetit; (IV) Përfshirjen e Institutit të Mjekësisë Ligjore, në momentin e parë që gjatë kërimit dhe gërmimit do të konstatohen mbetje mortore të personave të zhdukur; (V) ICMP-ja do të vazhdojë të ketë rol në fazën e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të gjetura; (VI) Instituti i Policisë Shkencore do të përfshihet në trajtimin e rasteve, kur grupi me ekspertë mjeko-ligjorë do të konstatojë fakte që evidentojnë elementë të një krimi.

Verifikimet/Hetimet administrative nisur nga kërkesat e familjarëve të të zhdukurve, si dhe për rastet e vrasjeve në kufi.

Në vitin 2022 u bënë në ndryshime dhe shtesa në dispozita të veçanta të ligji nr. 45/2015. Kështu, në nenin 5 të këtij ligji, u shtuan paragrafët 1.1 dhe 1.2 që mundësojnë kryerjen e verifikimeve administrative me qëllim qartësimin e rrethanave dhe fakteve të çështjeve të caktuara.

Nisur nga këto ndryshime, Autoriteti ka nisur fillimin e verifikimit administrativ, për gjetjen e eshtrave dhe qartësimin e fatit të të zhdukurve gjatë periudhës komuniste, si të burgosurve të ekzekutuar, të vrarë, apo të vdekur në burg, gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit, si dhe për rastet e para individuale të personave të zhdukur, mes të cilëve, rasti i të ndjerit Jup Kazazi, për eshtrat e të cilit, familjarë të tij, kanë kërkuar ndër vite, duke iu drejtuar institucioneve të ndryshme, por edhe duke ndërmarrë veprime në terren. Sa më sipër Autoriteti ka marrë 3 vendime, lidhur me Hetimin Administrativ:

- Vendimin nr. 372, datë 30.05.2023, për fillimin e hetimit administrativ me qëllim verifikimin dhe qartësimin e rrethanave dhe fakteve mbi të pagjeturit, për rastet e para që do t'i nënshtrohen hetimit administrativ;
- Vendimin nr. 374, datë 02.06.2023 për fillimin e hetimit administrativ me qëllim qartësimin e fatit, gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit, në Burgun e Spaçit;
- Vendimin nr. 535, datë 29.08.2023 për miratimin e fillimit të procedurës së verifikimit të thelluar administrativ, me qëllim identifikimin e vendvarrimeve të personave të vdekur ose të zhdukur në Shkodër, si dhe qartësimin e fatit, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të zhdukur, që i përkasin Shkodrës.

Në zbatim të këtyre vendimeve, janë kryer kërkime dhe vizita në vende të dyshuara, për të cilat janë marrë edhe dëshmi nga persona që kanë dijeni rreth tyre, si në: Mallkeq, Bashkia Selenicë, Shën Vasil bashkia Sarandë, fshati Vorfë, Njësia Administrative Gruemirë, Bashkia Malësi e Madhe, fshati Kërpicë, Bashkia Gramsh, fshati Grekan, Njësia Administrative Sulovë, Elbasan, fshati Shelegur, Bashkia Leskovik. Mbi këtë bazë, është arritur lokalizimi i vendeve të dyshuara si vendvarrime, është bërë shënjestrimi i koordinatave të tyre, si dhe realizimi i bar kodit për secilin rast sipas Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor Shqiptar.

Vëmendje e vecantë i është kushtuar evidentimit të të vrarëve apo të vdekurve në tentativë për të kaluar kufirin gjatë regjimit komunist, qartësimi i fatit dhe kërkimi deri në gjetjen e eshtrave të tyre, përbën një tjetër progres, ku Autoriteti është angazhuar. Kjo, e materializuar me aktivitetet e zhvilluara në Ersekë (Rehovë), si një vend me një numër të madh ngjarjesh, të vrasjeve dhe vdekjeve për këto motive, në përpjekje për të kaluar kufirin. Për këtë qëllim, janë realizuar takime në Bashkinë e Ersekës, ku është diskutuar rreth vendvarrimeve të mundshme të të zhdukurve në territorin administrativ të Kolonjës, identifikimin dhe vënien në mbrojtje dhe mbikëqyrje të posaçme, për t'i ruajtur nga tjetërsimi i mundshëm.

Në vijimësi, gjatë vitit 2023, ka filluar puna për memorialet që do të realizojmë në nderim të të vrarëve dhe zhdukurve nga diktatura, si në burgje, kampe, hetuesi, apo edhe në kufi. Janë diskutuar idetë dhe projektet e para, për një memorial të përgjithshëm në Tiranë, që të shprehë në mënyrë të plotë, pasojën e ardhur nga brutaliteti i diktaturës, të tregojë dinjitetin e mohuar të viktimave, dhimbjen dhe respektin shoqëror për to.

1.4. HULUMTIMI SHKENCOR DHE EDUKIMI QYTETAR

I. Mbështetja shkencore

Në zbatim të nenit 36, 37, 38 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 42 të Rregullores për “Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Autoriteti është përgjegjëse për:

- Informimin e studiuesve dhe mediave të interesuara për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe dorëzimin e dublikatave të tyre te kërkuesi, brenda afateve kohore të përcaktuara në akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit organik 45/2015, i ndryshuar;
- Mbështetjen e veprimtarisë hulumtuese, të kërkimit shkencor me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, apo të edukimit qytetar, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve.
 - **112** kërkesa studimore/mediatike janë paraqitur pranë Autoritetit, gjatë vitit 2023, që janë në faza të ndryshme të trajtimit. 23 praktika janë të mbyllura, materialet janë trajtuar dhe dokumentacioni është përpunuar e vënë në dispozicion të studiuesve/medias kërkuese të informacionit.
 - **35** relacione janë paraqitur në mbledhjet e Autoritetit, gjatë vitit 2023, për të cilat është përgatitur materiali përkatës për relativitet, me 108 kërkesa studimore, midis tyre, **116** vendime dhe për kërkesa të mbartura nga viti 2022;
 - Të gjitha vendimet e drejtorisë (**116**) janë anonimizuar për publikim në ueb dhe në buletinet e muajve përkatës;
 - **83** studiues kanë konsultuar dhe kanë tërhequr vendimet me dokumentacionet përkatëse pranë zyrave të Autoritetit dhe janë asistuar në përgatitjen e dokumentacionit përmbyllës nga specialistet e sektorit; siç janë deklaratat e përgjegjësisë dhe procesverbale për vënien në dispozicion me vendim nga Autoriteti, të dokumentacionit të gjetur e trajtuar;
 - Është miratuar vënia në dispozicion të studiuesve, sipas 116 vendimeve për 1329 dosje, me një total prej 138 010 faqesh, ndër të cilat, janë anonimizuar material dokumentar, me një total prej 10 522 faqesh.

II. EDUKIM QYTETAR

Projekte studimore dhe audio – vizuale

Në vijim të misionit, Autoriteti, gjatë vitit 2023, ka mbuluar veprimtari të shumta, si: takime, prezantime, shpallje platforme, ceremoni, shfaqje teatrale promovim libri me fokus të shkuarën, si dhe shumë aktivitete të tjera, për të cilat është përgatitur dokumentacioni përkatës.

Në total janë realizuar **49** aktivitete brenda dhe jashtë Autoritetit, që përkojnë me ditët përkujtimore, sipas kalendarit të kujtesës. Më poshtë, një prezantim sintetik i tyre:

Pjesëmarrje në Aktivitete:

- ❖ Pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Rrjeti Evropian i Kujtesës, ENRS, “Politikat e kujtesës si një armë” (9.02.2023), Berlin, Gjermani;
- ❖ Pjesëmarrje në Konferencën e Rrjetit Evropian të Arkivave të Policive Sekrete. Tetor 2023, në Berlin, Gjermani.

Marrëveshje bashkëpunimi:

- ❖ Autoriteti dhe Instituti i Historisë së Europës Mesdhetare (ISEM – CNR), nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi;
- ❖ Autoriteti dhe Qendra e Kreativitetit Teknologjik “TUMO”, bashkëpunojnë për krijimin e punimeve artistike me impresione nga Revolta e të burgosurve politikë të Spaçit;

Në Autoritet janë pritur:

- ❖ Kreu i delegacionit të BE-së, Ambasadorja Christine Hohman vizitoi Autoritetin dhe mbështeti misionin e tij në zbardhjen e së shkuarës komuniste (10.01.2023);
- ❖ Vizitë e një përfaqësie të Ambasadës Suedeze në AIDSSH (3.03.2023);
- ❖ Vizitë e ish-deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Vasilika Hysi;
- ❖ Takim me trashëgimtarët e doktorit të mirënjohur, prof. dr. Venanzio Lozzi;
- ❖ Takim me përfaqësues të Shoqatës Antikomuniste të ish-të Përndjekurve Politikë;
- ❖ Vizitë për bashkëpunim e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulture të Shqiptarëve - Shkup (ITSHKSH);

Aktivitete me mësues e nxënës, në shërbim të edukimit qytetar:

- ❖ Mësuesit e historisë, nga e gjithë Shqipëria, morën pjesë në Seminarin (online) Ndërkombëtar të Kujtesës, të organizuar Rrjeti Evropian i Kujtesës dhe Solidaritetit (ENRS);
- ❖ Shfaqje nga nxënës të gjimnazeve “Andon Zako Çajupi” dhe “Qemal Stafa”, në kujtim të datës 26 shkurt, të pjesës “Mendje të bukura, shpirtra të lirë”;
- ❖ Përkujtohen poetët mësues, Vilson Bllshmi dhe Genc Leka;
- ❖ Vizitë e nxënësve të shkollës jopublike “Torgut Ozal”, në ambientet e Autoritetit;
- ❖ AIDSSH në bashkëpunim me MAS, shpalli konkursin midis shkollave artistike, për krijimin e Logos: “50 vjet nga Revolta e Spaçit”;
- ❖ Orë mësimore e zhvilluar në gjimnazin “Qemal Stafa”, në përkujtim të revoltës së Spaçit, 21-23 maj 1973, në kuadër të 50-vjetorit;
- ❖ Vizitë e studentëve të shkollës verore “Historia Gojore”;
- ❖ Certifikata mirënjohjeje për nxënësit që krijuan logo kushtuar 50- vjetorit të Revoltës së Spaçit. Aktivitete informuese nga përfaqësia e Autoritetit, në secilën shkollë;

- ❖ Vizitë në ambientet e Autoritetit, nga nxënësit e gjimnazit jopublik "Protagonistët";

Aktivitete përkujtimore:

- ❖ Përkujtimi i Holokaustit - Autoriteti hap arkivat për hebrenjtë, më 27 janar 2023;
- ❖ Autoriteti në pelegrinazhin “Gjurmë qëndrese dhe solidariteti”, dedikuar të mbijetuarve të kamp-burgut të Spaçit dhe familjarëve të tyre, në kuadër të 50-vjetorit të Revoltës;
- ❖ Përkujtohet 74-vjetori i masakrës së Qafës së Valmirës;
- ❖ Përkujtohet 30 gushti, dita ndërkombëtare e të zhdukurve, në Shkodër, pranë “Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës”;
- ❖ Autoriteti merr pjesë në aktivitetin e organizuar në përkujtim të Kryengritjes së Zhapokikës;
- ❖ Në Autoritet u shfaq filmi “Urdhra vrasjesh nga Beogradi”, i regjisorit kroat, Dragan Kotić;
- ❖ Takim në Autoritet i një përfaqësie të Institutit të Historisë së Europës Mesdhetare;
- ❖ Takim me autoritete lokale: Prezantohet projekt-memoriali për shenjimin e vendvarrimeve të mundshme të të pagjeturve në territorin administrativ të Kolonjës;

Ekspozita:

- ❖ Ekspozitë dokumentare, lëvizjet demokratike në syrin e ish-Sigurimit të Shtetit dhe prezantim i platformës digjitale “Të mësojmë nga e kaluara - burime arsimore të hapura, 1944-1991”;
- ❖ Ekspozitë “Të zgjedhur”, në përkujtim të 76 - vjetorit të ekzekutimit politik të deputetëve dhe intelektualëve, më 10 tetor 1947;
- ❖ Ekspozitë arkivore “Spaçi në arkiva”, në kuadër të 50-vjetorit të Revoltës;

Tryeza, konferenca, seminare dhe ligjërata:

- ❖ Ligjëratë me temë: “Qasja në dokumente sekrete, si mjet i pazëvendësueshëm në konsolidimin e demokracisë”, nga Dr. Gjon Boriçi;
- ❖ Tryezë e rrumbullakët mbi punën e papaguar të ish-të burgosurve politikë në miniera;
- ❖ “Spaçi në Arkiva – 50 vjet nga Revolta”, aktivitet për nxitjen e akademikëve mbi qasjen juridike në dokumente;
- ❖ Simpozium Shkencor Ndërkombëtar “Tepelena në dy kohë - nga kazermat italiane, te kampi me tela me gjemba”, në kuadër të 23 gushtit, Ditës Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare;
- ❖ “Përdorimi i dosjeve të policive sekrete, për mësimin e historisë së regjimeve totalitare, si pjesë e edukimit për demokraci në shkollë” - Seminar Ndërkombëtar për mësimin e historisë në shkolla, 19-20 dhjetor 2023;
- ❖ Të sakrifikuarit, “Dosja e hapur” mbi dosjet e Xhahit Toptanit dhe Abdyl Këllezit, referuar nga Dr. Gjon Boriçi.

Seksioni II. Të dhëna mbi mbështetjen shkencore dhe edukimin qytetar

MBËSHTETJA SHKENCORE	EDUKIMI QYTETAR
✓ 116 vendime	✓ 56 botime në letër
✓ 112 kërkesa studimore	✓ 59 botime online
✓ 2 kërkesa mediatike	

✓ 1329 dosje të vëna në dispozicion ✓ 138 010 faqe të vëna në dispozicion ✓ 10 522 faqe të anonimizuara	✓ 300 publikime në media sociale dhe tekste për faqen zyrtare ✓ 60 video të regjistruara për ish-të dënuarit e Spaçit dëshmi të familjarëve të tyre ✓ 60 orë intervista të transkriptuara ✓ 49 takime-aktivitete brenda dhe jashtë Autoritetit ✓ Mbulim me foto dhe video të gjithë aktivitetit të Autoritetit përgjatë gjithë vitit ✓ 35 njoftime për shtyp ✓ 180 faqe kalendar për komunikimin në mediat sociale, me informacione mbi dosje, data përkujtimore, veprimtari të Autoritetit dhe bashkëpunime me partnerët ✓ 30 video të përgatitura për aktivitete dhe komunikim publik online
---	---

1.5.SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK

- ❖ Gjatë të gjithë vitit, Autoriteti, përmes Drejtorisë së Sigurisë, *ka monitoruar sigurinë fizike*, zbatimin e urdhrave të hartuara për vendosjen e parametrave të kërkuar të sigurisë për informacionin e klasifikuar. Gjithashtu, në çdo rast, janë mbajtur kontakte me Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorinë për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Repartin Ushtarak Nr. 6630, për lehtësimin e hyrje-daljeve të vizitorëve, aplikantëve dhe personave të ftuar në Autoritet. Gjatë eventeve të mbajtura në ambientet e Autoritetit, si punimi (workshopi) me teme “Sfidat e mësimdhënies së historisë dhe rishqyrtimi i rolit të shqiptarëve në shmangien e ndikimit të Holokaustit, në Shqipëri dhe Kosovë”, aktiviteti përkujtimor i Ditës së Kujtesës Kombëtare për Martirët dhe Viktimat e Regjimit Komunist, aktivitetit “Spaçi në Arkiva 20 vjet nga revolta”, projekti “Tirana në sytë e Sigurimit të Shtetit”, “DOSJA E HAPUR” e Xhahit Toptanit dhe Abdyl Këllezit etj., është asistuar në lehtësimin e hyrje-daljeve të të ftuarve, si dhe është arritur siguria në çdo moment përmes survejimit nga kamerat.
- ❖ Është monitoruar gjatë gjithë vitit zbatimi i urdhrave të hartuara për vendosjen e parametrave të kërkuar të sigurisë, për informacionin e klasifikuar. Në zbatim të Urdhrit “Për zonat e sigurisë dhe plani i masave”, Urdhrit “Për administrimin e çelsave”, janë kryer procedurat e prokurimit për blerjen e kasafortave, si dhe janë vendosur çelësat, sipas rregullores, në kasaforta. Gjithashtu, në zbatim të Urdhrit për regjimin e hyrje-daljeve në Autoritet, janë konfiguruar dhe shpërndarë kartat e hyrjes për punonjësit e Autoritetit. Është mbikëqyrur instalimi dhe konfigurimi i sistemit të shuajtjes së zjarrit, si dhe është mbikëqyrur vendosja dhe konfigurimi i sistemit të alarmit.

- ❖ Vazhdon të bëhet mirëmbajtja dhe përditësimi me materiale, informacione, dokumente, njoftime, etj. Në këtë kuadër, punohet, jo vetëm për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të Autoritetit: www.autoritetidosjeve.gov.al, por edhe për përditësimin dhe editimin e rubrikave, përditësimin me informacione, njoftime për shtyp, konferenca shkencore, vendimet e Autoritetit, deklasifikimet, publikimet e vendeve të lira të punës etj. Kjo transparencë ndihmon në mirinformimin e publikut, me qëllim arritjen të një numër sa më i madh qytetarësh-përdorues të faqeve online, për marrjen e një informacioni sa më të plotë, si dhe për sensibilizimin e tyre, për t'u bërë pjesë e këtij procesi. Publikimet janë kryer dhe në ISSUU për lehtësimin e aksesimit të botimeve të Autoritetit nga përdoruesit. Për këto faqe, janë mbajtur edhe statistika mujore mbi shikueshmërinë dhe është vënë re, se ndjekja nga publiku është në rritje çdo muaj.

Në faqen zyrtare, gjithashtu është shtuar një nënmenu e re, në kuader të mbështetjes shkencore dhe edukimit qytetar, e titulluar “Tepelena në Dy kohë”. Në këtë uebfaqe janë hedhur punimet në vijim, të Simpoziumit Shkencor Ndërkombëtar, të zhvilluar në Tepelenë, gjatë muajit Gusht të vitit 2023, aktivitetet që u asistua nga ekspertet e IT.

- ❖ Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fushën e informacionit të klasifikuar dhe në zbatim të VKM-së nr. 542 datë 25.07.2019 dhe VKM nr. 312 datë 16.03.2011, informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”, që shkëmbehet nëpërmjet rrjeteve informative, kryhet kur pajisjet janë të certifikuara përshtatshëmrisht. Është hartuar dokumentacioni për procedurat e operimit të sigurt dhe koncepti i operimit të sistemit, me qëllim nisjen e procesit të akreditimit të sistemit, si dhe janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me AKSIK.
- ❖ Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit, në mënyrë permanente ka për detyrë të mirëmbajë kompjuterët e instaluar pranë çdo punonjësi dhe të ndërhyjë me efektivitet për rregullimin e defekteve. I njëjti proces pune ndiqet dhe me printerët, skanerët, skanerët e avancuar, skaner microfilm, lexues microfilm, etj. Në funksion të përmirësimit cilësor të punës dhe në konsiderimin e përdorimit të teknologjive të reja, duhen instaluar programe në kompjuter sipas kërkesave të secilit punonjës. Në çdo moment është ndërhyrë në rast problemi printimi, konvertim word-pdf / jpg-word / jpg-pdf, etj. Krahas kësaj, në rastet e nevojshme kryhet vendosja e programit të gjuhës shqipe, mirëmbajtja e sistemit audio, hapja e adresave zyrtare (AKSHI), përditësimi i fjalëkalimeve një herë në tre muaj, sipas rregullores së AKSHI-t, etj. Instalim programesh në kompjuter, sipas kërkesave të secilit punonjës, skanim shkresash, materialesh, problem printimi, etj

6. OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2024

Objektivat kryesorë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2024:

1. Mbështetja e verifikimit për qëllime rehabilitimi ose dëmshpërblimi (pensionet).
2. Informimi i kërkuarve për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
3. Identifikimi, mbledhja dhe krijimi i një arkivi të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura, të prodhuara ose të lidhura me veprimtarinë e ish-Sigurimit.
4. Themelimi i Autoritetit si një burim arkivor qendror, për kërkime mbi aktivitetet e Sigurimit.
5. Shkurtimi i kohës së shërbimit të informacionit arkivor nëpërmjet skanimit të dokumentacionit arkivor dhe vënien në funksion të programit të arkivës digjitale me kapacitet të lartë.
6. Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zyrtarëve, por edhe të kodit zgjedhor, apo ligjit për partitë politike në përputhje me standardet ndërkombëtare.
7. Përmirësimi i procedurave të ndjekura për verifikimin e subjekteve, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm, për institucionin; të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit.
8. Konsolidimi i Autoritetit si burim arkivor qendror, për kërkime mbi aktivitetet e Ish-Sigurimit, Informacion për të gjithë, në kuadër të informimit, apo të studimit, nëpërmjet krijimit të lehtësirave proceduriale, digjitalizimit dhe zgjerimit të spektrit në informacionin e aksesueshëm;
9. Edukim dhe ndërgjegjësim shoqëror nëpërmjet një platforme komunikimi në spektrin 360 gradë dhe një narrativë të përmbledhur dhe më të prekshme, për të ftuar dhe afruar të gjithë brezat, në një dialog më të gjerë mbi të shkuarën;
10. Zbatimi i strategjisë së komunikimit në vend dhe jashtë tij, me grupet e synuara, partnerët dhe homologët për zbardhjen e së shkuarës
11. Kryerja e veprimtarive informuese nga Autoriteti, në bashkëpunimi me partnerë lokalë kombtarë dhe ndërkombtarë, në terren, për ta prezantuar Autoritetin si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri.
12. Promovimi i transparencës dhe drejtësisë tranzicionale
13. Mbështetja e punës së dokumentimit të krimeve të komunizmit, duke përfshirë kontributin në vënien e drejtësisë.
14. Mbështetja e procesit të identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të viktimave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.
15. Rritja e kapaciteteve të BNJ të institucionit nëpërmjet plotësimit të vakancave aktuale, shtesave në strukturë, si dhe trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, pranë institucioneve homologe.
16. Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të ligjit nr. 45/2015, duke përfshirë edhe aktet e brendshme për mirëfunksionimin e AIDSSH.

17. Menaxhim me efektiv i prokurimeve të fondeve buxhetore, nëpërmjet një planifikimi sa më realist, të nevojave të institucionit, në përputhje me ligjin 'Për prokurimin Publik', të ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi.
18. Mirëfunksionimi i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financave në zbatimin korrekt dhe profesional të detyrave funksionale dhe të gjithë bazës ligjore, plotësimi i strukturës, organikës së kësaj drejtorie, si dhe rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të përfshira në këtë drejtori, nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, pranë institucioneve homologe.

7. SYNIMET PËR TË ARDHMEN

Vizioni i Autoritetit është përshtatja me modelet e institucioneve homologe të vendeve ish-komuniste, si institucion kujtese, ku Autoriteti:

1. Është një platformë e besueshme, me një sistem të sigurt teknologjik të shërbimit të të dhënave, nga ku mundësohet trashëgimia dokumentare e ish-Sigurimit të Shtetit, nga brenda e jashtë vendit, për të kërkuar të dhëna, informacion dhe kontekst nga arkivat e Sigurimit, mbi përvojën e shtypjes komuniste;
2. Rrit ndërgjegjësimin e publikut për regjimin komunist, duke dhënë informacion mbi veprimtarinë e Sigurimit dhe kontekstin përkatës, duke ndihmuar në parandalimin e intolerancës, ekstremizmit, lëvizjeve antidemokratike dhe përsëritjen e totalitarizmit;
3. Ndërmerr hapa institucionalë për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare, me institucionet shqiptare të ngarkuara për këtë qëllim.
4. Mbështet dhe nxit angazhimin publik, duke mbështetur vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës dhe pajtimit, duke krijuar mjedise të posaçme për leximin, studimin dhe ekspozimin e materialeve arkivore dhe studimeve, për periudhën 1944-1991.
5. Inkurajon programe edukuese, shkollore, akademike, në disa nivele, pranë dhe për Autoritetin;
6. Inkurajon ndërtimin e platformave për amendimin e mësimdhënies së historisë, gjuhës e letërsisë dhe edukimit qytetar e filozofisë, duke përdorur mjete ilustruese të besueshme, bazuar në dokumentacionin e administruar në Autoritet.
7. Mbështet trajtimin profesional të pasojave të traumës në viktimat e dhunës gjatë komunizmit, me programe të posaçme mbi trajtimin e viktimave, familjarëve, pasardhësve për gjurmët e së shkuarës në realitetin me të cilin përballen.
8. Mbështet diskutimet e hapura dhe dialogjet lokale, për të kaluarën komuniste dhe pasojat, bazuar në transparencë, integritet, bashkëpunim me individë dhe institucione qendrore dhe të pushtetit lokal.
9. Ndërton bashkëpunime ndërinstitutionale për vënien në vend të dinjitetit të viktimave, personave të thjeshtë, apo personaliteteve të përndjekur në diktaturë, të

- cilët, vijojnë të mbajnë stigmën e propagandës komuniste, për shtrembërimin e profilit personal e shoqëror në letërsi, art, kinematografi, histori, etj.
10. Mbështet punën për dokumentimin e krimeve të komunizmit, përfshirë kontributin për vënien e drejtësisë.
11. Krijon facilitetet e duhura nëpërmjet deklasifikimit tërësor të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti, në shërbim të subjekteve të interesuara (individuale, studimore, mediatike, qytetare, institucionale, të familjarëve të të zhdukurve etj.).

8. DETYRIMET LIGJORE NGA AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSITË NË RASTET KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR, APO NUK ËSHTË KONSIDERUAR

- a. Në komunikim aktiv me publikun dhe të interesuarit për realizimin e detyrave funksionale, Autoriteti është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi.**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, nuk ka pasur raste tejkalimi, apo keqpërdorimi të kompetencave në ushtrimin e funksioneve për të cilat, ligji nr. 45/2015, i ndryshuar dhe Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit e ngarkojnë. Autoriteti në bashkëpunim me komisionerin për të drejtën e informimit ka përditësuar programin e transparencës së Autoritetit, duke bërë publike të gjitha dokumentet parashikuar në ligjin nr. 119/2014, i ndryshuar .

Nga ana e Koordinatorit për të drejtën e Informimit janë dhënë, brenda afatit kohor ligjor, përgjigje për 14 kërkesa të paraqitura pranë Autoritetit, për informacion në bazë të ligjit nr 119/2014. Vetëm për një kërkesë, ka pasur ankim pranë Komisionerit (shtetasi Q.Q.), por procedura nuk ka vijuar më tej, me shqyrtimin e ankimit nga ana e Komisionerit, për shkak të përcjelljes së informacionit kërkuar, menjëherë pas deklasifikimit.

- b. Niveli i zbatimit të Kodit të sjelljes së mirë administrative dhe Kodit të Etikës nga sekretariati teknik dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi**

Ky kod është krijuar për të promovuar si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit një kulturë administrative, të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, si dhe ofron udhëzime në lidhje me hapat praktikë që duhen ndjekur, për të siguruar më shumë efektshmëri, transparencë dhe përgjegjësi. Në këtë kuadër, theksojmë se, në veprimtarinë e përditshme të punës në komunikimet me titullarin, anëtarët e Autoritetit, me kolegët, si dhe me subjektet e interesuara që i drejtohen Autoritetit dhe që paraqesin kërkesa për informim, punonjësit e institucioneve të tjera të administratës publike/ personave të tretë, të lidhur me ta, udhëhiqet në çdo rast, nga respektimi i parimeve bazë të ligjit nr.45/2015 i ndryshuar, të zbatimit të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, ndryshuar me vendimin nr. 234, datë 24.04.2019 të Autoritetit, të “Kodit të sjelljes së mirë administrative dhe Kodit të Etikës, nga sekretariati teknik dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi”, si dhe të zbatimit të çdo akti tjetër ligjor, apo nënligjor që na ngarkon për zbatim.

c. Veprimtaria në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të ligjit për kontrollin e interesit, pjesë e Autoritetit

1. Hartimi i raportit vjetor të vitit 2023 dhe dërgimi brenda afateve ligjore të Raportit, pranë ILDKPKI.
2. Njoftimi dhe ndjekja e afateve ligjore, për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private periodike vjetore, para fillimit në detyrë dhe pas largimit nga funksioni të subjekteve deklaruese të Institucionit.
3. Rakordimi i listës së subjekteve midis Institucionit të Autoritetit dhe ILDKPKI-së.
4. Përgatitja dhe administrimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të Udhëzimit për Autoritetin Përgjegjes, me qëllim vënien në dispozicion të Institucionit kontrollues dhe monitorues të ILDKPKI-së.
5. Ndjekja e dorëzimit elektronikisht dhe zyrtarisht, brenda afateve ligjore, të deklaratave të interesave private periodike vjetore, të të gjithë subjekteve deklaruese të Autoritetit.
6. Asistencë për secilin nga subjektet deklaruese të Autoritetit, të cilët kanë ndier nevojën për ndihmë. Komunikim i vazhdueshëm, me nëpunëset e ILDKPI-së.

Në vitin 2023, janë bërë subjekt deklarimi shumë lëvizje të personelit, të cilët, janë njoftuar për deklaratat e tyre “Para fillimit të detyrës” dhe “Pas largimit nga funksioni”, për të cilët është bërë dhe njoftimi i institucionit të ILDKPI-së, për ndryshimet në regjistrë.

7. NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR, PËR VITIN 2023 DHE EFEKTET E TYRE

Autoriteti, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, ka hartuar një sërë rregullash dhe normash që i vijnë në ndihmë mirëfunksionimit të institucionit, për të bërë më të qartë dhe transparente vendimmarrjen dhe veprimtarinë e punës, që kryesisht, janë si më poshtë:

1. Vendimi i Autoritetit për miratimin e Planit vjetor të veprimtarisë për vitin 2023, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, që përcakton drejtimit kryesore të Autoritetit, për përmbushjen e detyrave të parashikuara në legjislacionin që normon veprimtarinë e institucionit.
2. Vendimi i Autoritetit për miratimi i udhëzuesit nr.625/10, date 30.03.2023 për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Gjatë vitit 2023, janë përgatitur dhe nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë:

❖ **Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.** Kjo marrëveshje, ka si objekt bashkëpunimin midis dy institucioneve të lartpërmendura, në fushën e shkëmbimeve të informacionit dhe të dokumentacionit, si dhe të aktiviteteve të përbashkëta në vijim të botimeve që burojnë nga këto dokumente, po ashtu edhe

institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve dhe të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste.

Bashkëpunimi në fushën e materialeve digjitale, rubrikave mediatike, online, videove sensibilizuese, dëshmime gojore, të botimeve, etj., mbi kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë mbi krimet e diktaturës dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

❖ **Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Institutit të Historisë së Evropës Mesdhetare të Kaljarit, Romës dhe Milanos**, pjesë e Këshillit Kombëtar Italian të Hulumtimit (ISEM-CNR); Objekti i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të kontakteve dhe diskutimeve mbi çështjen me interes të përbashkët, veçanërisht për shkëmbimin e njohurive, informacionet, ekspertizës, dhe praktikave me të mira mbi arkivat, duke shkëmbyer po ashtu, të dhëna dhe materiale arkivore dhe dokumente historike, me interes të përbashkët.

Përveç marrëveshjeve të miratuara gjatë vitit 2023, është vijuar me bisedimin dhe përgatitjen e 4 marrëveshjeve të tjera, që pritet të miratohen në vitin 2024, me Shkollën e Magjistraturës ATSH, RTSH dhe ISKK.

8. MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA NË VEPRIMTARINË E AUTORITETIT ME QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I MINISTRAVE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ka paraqitur disa problematika që janë hasur gjatë punës dhe që përkthehen në propozime të mundshme, për të bërë disa ndryshime, apo shtesa në ligjin funksional nr. 45/2015, *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, apo të ndonjë ligji tjetër, që do të ndikonin në cilësinë e punës.

Problematikat që kanë dalë gjatë veprimtarisë funksionale të Autoritetit, janë si më poshtë:

1. Vazhdon të mbetet problem, fakti që një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të ish-Sigurimit të Shtetit ndodhet nëpër arkivat e institucioneve, si trashëgimi institucionale e papërdorshme dhe ndoshta, jo e njohur mirë nga administratorët. Kjo tashmë, nuk mund të trajtohet e mbetet, vetëm shqetësim dhe paqartësi mbi detyrimin e autoriteteve të tjera shtetërore, të dorëzojnë dokumente që mund të mos (konsiderohen) të kenë lidhje, me atë nocion të paqartë të ish-Sigurimit të Shtetit. Siç e kemi trajtuar edhe më herët, Autoritet është institucioni i krijuar me ligj dhe i specializuar për realizimin dhe kryerjen e një procesi të tillë dhe mbetet i hapur dhe i gatshëm që të marrë përgjegjësi dhe japë ndihmesë. Po kështu jemi të vetëdijshëm se, lidhja e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit me veprat penale politike ka

vështirësi, për vetë faktin, se një pjesë e madhe e dokumenteve janë të asgjësuar, gjë që sjell vështirësi teknike, për stafet e institucioneve dorëzuese dhe institucioneve marrëse. Në këto kushte kërkohet angazhim dhe bashkëveprim ndërinstitucional në mënyrë që të lehtësohet procesi i identifikimit dhe dorëzimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, pranë Autoritetit.

2. Si rezultat i kërkesave të shtuara pranë Autoritetit, gjatë vitit 2022, mbi njohjen dhe dëmshpërblimin e viteve të internimit të fëmijëve që kanë jetuar më familjet e internuara, të përfshihen në ligjin përkatës, duke i trajtuar në mënyrë të barabartë me prindërit e tyre (janë ngritur grupe pune për këtë qëllim, për dokumentimin e rasteve). Duke pasur parasysh, disa problematika si fakti që koha e internimit dhe e dëbimit për motive politike, nuk njihet si vjetërsi pune për të lindurit në internim, apo ata që nuk kishin mbushur moshën 15 vjeç, kemi sugjeruar ndryshime ose që të krijohet një skemë e veçantë dëmshpërblimi për këtë kategori. Gjetjen e mekanizmave për të vërtetuar vitet e internimit të këtyre shtetasve, duke u bazuar nga të dhënat që mund të gjejmë për familjarët e tyre etj. Në mënyrë që të sjellim propozimet tona “Për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarave politike të regjimit komunist” është ngritur edhe ky grup pune, që ka zhvilluar disa takime dhe bërë përgatitje paraprake, pa hedhur hapa të tjerë konkretë.
3. Në vitin 2022 është raportuar mbi problemin e transferimit të Autoritetit në ambientet e garnizonit “Skënderbej”, çfarë pati si rezultat vështirësitë me të dhënat, për individë dhe studiues të ndryshëm, të cilët kërkojnë pranë Autoritetit, mundësinë për të plotësuar formularë, tërheqjen/konsultimin e dokumenteve, informacion mbi praktikën, etj. Po ashtu, për shkak të zbatimit të protokolleve të sigurisë së garnizonit, shtetasi të huaj e kanë të vështirë hyrjen në mjediset e Autoritetit. Ndalimi i hyrjes dhe kushtet e papërshtatshme për plotësimin e formularit, sjellin pakënaqësi tek aplikuesit. Për këtë arsye, kërkohet që zona ku ndodhen e ambientet e Autoritetit të jetë zonë civile dhe të mos jetë pjesë e rregullave të garnizonit, si rezultat i kthimit në institucion kujtese. Vazhdon të mbetet problem edhe në vitin 2023.
4. Zbatimi i VKM-së nr. 98/2017, me objekt realizimin e procesit të kalimit nën administrim dhe të marrjes në dorëzim të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, vijon të ketë vështirësi me procesin e dorëzimit të fondeve arkivore. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, nuk është dorëzuar asnjë fond, apo dokument arkivor, pranë Autoritetit. Gjatë komunikimeve zyrtare pretendohet se, fondet janë të papërpunuara dhe ka vështirësi në identifikimin e dokumenteve të ish Sigurimit, proces ky që kërkon shumë burime njerëzore dhe kohë.
Ligji nr 45/2015 parashikon ndër dokumentet e ish – Sigurimit në nenin 3 pika 5 gërma c) “dokumentet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji”. Kalimi në administrim i këtyre

dokumenteve arkivore nga DPA është i domosdoshëm, në mënyrë që Autoriteti të ushtrojë plotësisht detyrën e tij ligjore lidhur me verifikimin në këto fonde, kur kërkohet për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, propozimet për dekorim, dhënie titujsh nderi dhe emërtime hapësirash publike.

5. Problematikë për Autoritetin, ka qenë dhe mbetet Vendimi i Këshilli të Ministrave, “Për gjetjen, identifikimin, rekuperimin e eshtrave dhe mënyrën e mbrojtjes e ruajtjes së vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë periudhës 29 nëntor 1944-2 korrik 1991”. Siç e kemi bërë të njohur edhe më herët, Autoriteti ka përgatitur draft-dokumentin dhe ua ka përcjellë institucioneve të tjera përgjegjëse, si: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë, etj. Ky akt normativ është dhe vazhdon të mbetet vendimtar, sepse kuadri ligjor aktual përcakton institucionet përgjegjëse, por nuk parashikon teknikat sesi duhet të zhvillohet i gjithë procesi për identifikimin dhe rikuperimin e personave të zhdukur, si dhe ruajtjen në mënyrën më të mirë të mundshme, të vendvarrimeve të njohura, apo të dyshuara si të tilla, të personave të zhdukur. Mosmiratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave lidhur me këtë çështje, na ka privuar nga vijimi i mëtejshëm i punës sonë në procesin e fillimit të gërmimit për rastet që janë paraqitur pranë Autoritetit. Do të vazhdojmë të përpiqemi, në lidhje me këtë çështje.
6. Vijnë të mbetet problematikë, mungesa e bashkëpunimit nga ana e shumë prej organeve të pushtetit vendor, për zbatimin korrekt të ligjit, nga ana e Autoritetit, për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh. Nga 61 bashki, vetëm 10 (dhjetë) prej tyre, kanë marrë në konsideratë procesin e verifikimit.
7. Vijnë po ashtu, të mbetet problematikë mosmarrja në konsideratë dhe mungesa e bashkëpunimit nga ana e partive politike, apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore, në kuadër të vlerësimit të pastërtisë së figurës të kandidatëve për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta, të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet prej tyre, për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale, parashikuar në nenin 30 të ligjit nr 45/2015.
8. Në vitin 2023, si pasojë e reformës në sistemin e pagave në shërbimin civil, është krijuar një diferencë ndërmjet pagave të sekretariatit teknik dhe pagave të anëtarëve. Kjo diferencë, vjen për arsye të komponentit të vjetërsisë, që përlllogaritet me koeficient shumë favorizues për nëpunësit me vjetërsi të konsiderueshme, ndërsa për anëtarët, vjetërsia nuk merret në konsideratë. Kjo lloj difference e krijuar, ka dëmtuar hierarkinë e pagave në institucionet kolegjiale. Për rrjedhojë, nevojitet gjetja e mekanizmit që mundëson rregullimin e pagës për organin kolegjial. Referenca e

pagës së Anëtarëve të autoritetit, në raport me pagën e Presidentit të Republikës është ulur: nga 55% që ishte, në 45 %, - që do të thotë, se referenca për pagën e Anëtarëve të Autoritetit, në fakt është ulur ekzaktesisht 19%, si dhe kjo diferencë bëhet më e dukshme, në raport me gjithë institucionet e tjera të krijuara me ligj, duke na veçuar dhe në trajtimin me këto institucione, që nuk u është ulur vlera e punës në raport me pagesën e Presidentit.

9. NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E AUTORITETIT DHE IMPAKTI I TYRE

Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, është ndryshuar në vitin 2022. Në vitin 2023, nuk ka pësuar ndryshime.

10. NEVOJA PËR NDRYSHIME NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT OSE NË PËRGJITHËSI NË LIGJE, AKTE NËNLIGJORE, APO DISPOZITA QË JANË DETYRUESE PËR INSTITUCIONIN NË MONITORIM.

Me poshtë paraqiten problemet e hasura gjatë punës së autoritetit, gjatë zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të realizimit të detyrave për vitin 2023, mbi zgjidhjen e të cilave kërkohen ndryshime ligjore

1. Në kuadër të objektivave dhe të angazhimeve të Autoritetit lidhur me ditët e kujtesës, si një përpjekje e domosdoshme e shoqërisë shqiptare për nderimin dhe kujtimin e figurave me rëndësi historike, Autoriteti ka propozuar disa ndryshime në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, konkretisht në nenin 202, pas gërmës “g”, shtohen gërmat “gj” dhe “h”, si më poshtë vijon: gj) Muzeu Kombëtar “Kampi i Punës së Detyruar të të Burgosurve Spaç”, h) Muzeu Kombëtar “Kampi i Internimit ‘Tela me Gjemba’ Tepelenë”.
2. Bazuar në praktikat e deritanishme të Autoritetit, ku pas verifikimeve lidhur me pastërtinë e figurës kryer në dokumentacionin arkivor që administrojmë, ka rezultuar se ekzistojnë të dhëna dhe dokumente të krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit, për bashkëpunimin me këto struktura (si bashkëpunëtorë, dëshmitarë në procese politike, denoncues etj.), në emër të personave, të cilët, më pas janë propozuar për medalje ose tituj nderi, në kuadrin e harmonizimit ligjor të dispozitave të parashikuara në këtë drejtim. Autoriteti ka paraqitur propozime konkrete, që në projektligjin për dhënien e dekoratave, të parashikohet një dispozitë për detyrimin e institucioneve/autoriteteve përgjegjëse për dhënien e dekoratave, që të paraqesin kërkesë për verifikimin e kandidatëve përpara dekorimit ose dhënies së titujve të nderit, me qëllim zhvillimin e procedurave të verifikimit të pastërtisë së figurës të shtetasve të propozuar, për periudhën kohore, nga 29 nëntor 1944 deri në datën 02 korrik 1991, si fushë e veprimit të ligjit 45/2015 i ndryshuar, në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore që kanë institucionet shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

3. Për të mundësuar zgjidhjene problematikës 7, sa më sipër Autoriteti ka paraqitur më herët, disa propozime për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor, që do të krijojnë hapësirën ligjore për të kryer verifikimin e të gjithë kandidatëve që kandidojnë në zgjedhje.
4. Ndryshime në legjislacionin për pagat, për ruajtjen e hierarkisë së pagave në institucionet kolegjiale, si dhe shpërblimin për gradat shkencore.
5. Propozime për disa ndryshime lidhur me "Projektvendimin për propozime në projektligjin 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, 'Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarave politikë të regjimit komunist', i ndryshuar".

11. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT - STRUKTURA DHE ORGANIKA E AUTORITETIT


Struktura dhe organika e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, nr. 95/2016, *"Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit"*, i ndryshuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.26/2022, datë 17.3.2022, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit'"*, ndryshuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr.19/2023, datë 16.3.2023, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, 'Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit'"*, u ndryshua struktura dhe organika e AIDSSH-së, si dhe u rrit numri total i punonjësve, nga 65 në 73. Nga kjo strukturë konsiston që 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me vendimet përkatëse; nr.43, nr.44, nr.45, nr.46, nr.47, datë 09.06.2022

Për vitin 2023, numri i punonjësve efektivë, në total është 64 ose 87 % e strukturës së miratuar, nga të cilët:

1. Anëtarë të Autoritetit, 5
2. Nëpunës Civilë, 53
3. Punonjës me "Kod Pune", 6
4. Vende vakante, 9

Nisur nga fakti i shfuqizimit të VKM Nr. 187, datë 8.3.2017, *"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të*

ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” e ndryshuar, që u zëvendësua me VKM Nr. 325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin Nr.113/2023, datë 2.11.2023, Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar”, reflektoi ndryshimet përkatëse të klasave dhe kategorive të nëpunësve civilë në strukturën dhe organikën e AIDSSH, si më poshtë:



Punësimi i punonjësve sipas organigramës

Siç është theksuar më sipër në pikën 4, në fund të vitit 2024, rezultojnë 9 vende vakante, me fond page për rekrutim janë: - 1 Drejtor i Përgjithshëm; - 2 punonjës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues; - 6 punonjës në nivelin ekzekutiv. Nga ana e Autoritetit janë publikuar vendet vakante të sipërcituara, sipas planit vjetor të rekrutimit, por këto vende kanë mbetur

vakante për arsye të dorëheqjes nga pozicioni sipas strukturës të Autoritetit, lëvizjes paralele, apo mungesës së kandidatëve të interesuar për procedurat e shpallura.

Gjatë vitit 2023, janë kryer në total 32 procedura rekrutimi. Kanë shprehur interes në këto procedura 66 kandidatë, nga të cilët, janë kualifikuar për të hyrë në testim 52 kandidatë. Pas kryerjes së procedurave të përzgjedhjes sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për rekrutimet, janë shpallur fitues 8 kandidatë. (Aneks 3, tabela 4)

Punësimi i punonjësve me kontratë të përkohshme

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 56 datë 1.2.2023 *“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”*, AIDSSH-së iu dha e drejta për të punësuar 20 (njëzetë) punonjës me kontratë të përkohshme, përkatësisht në pozicionet:

- 1 (një) punonjës me emërtimin “Teknik i Mesëm”;
- 5 (pesë) punonjës me emërtimin “Operator”;
- 5 (pesë) punonjës me emërtimin “Punonjës arkive”;
- 8 (tetë) Specialist, Drejtoria e Informacionit
- 1 (një) punonjës me emërtimin “Bibliotekar”

Puna vullnetare pranë Autoritetit

Gjatë vitit 2023, në përgjigje të kërkesave të ardhura për punë vullnetare pranë Autoritetit, janë zhvilluar të gjithë procedurat dhe është plotësuar i gjithë dokumentacioni përkatës, për kryerjen e punës vullnetare pranë Autoritetit, për 3 (tre) persona, gjatë një periudhe mesatare 3 (tre) – 6 (gjashtë) mujore.

Gjatë vitit 2023, në kuadër të Thirrjes së VIII të “Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”, nisur, drejtuar dhe udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, u realizua bashkëpunimi me këtë Ministri për identifikimin, ndjekjen dhe plotësimin e të gjitha procedurave dhe dokumentacionit përkatës, për kryerjen e praktikës pranë AIDSSH-së, nga ana e 2 praktikantëve, për një periudhë 3 (tre) mujore.

Trajnimet e punonjësve

Gjatë vitit 2023, në bashkëpunim me ASPA dhe institucione të tjera, janë kryer on-line një pjesë e konsiderueshme e trajnimeve, ku përfshihen dhe trajnimet e 7 punonjësve në kuadrin e pranimit në shërbimin civil, me temë *"Prezantimi me Administratën Publike"*.

Temat në këto trajnime, janë përzgjedhur nga punonjësit, për përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe ngritjes profesionale, në funksion të realizimit të detyrave sipas pozicioneve të punës, apo dhe të detyrave të reja të ngarkuara. Gjithsej, 36 punonjës kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga ASPA, për vitin 2023

Statusi i punonjësve sipas organigramës dhe ndryshimet deri në muajin dhjetor 2023

Lloji i organit		Autoriteti		Sekretariati Teknik			Të tjerë			
Lloji i punonjësve		Nr.anët arëve me fond page të aprovuar	Nr.anëtarëve të plotësuar	Nr.punonjësve me fond page të aprovuar	Nr.punonjësve të rekrutuar	Nr.punonjësve të larguar (dorëhequr, lëvizur, institucion e të tjera	Punonjës me kohë të pjesshme me kontratë	Punonjës paguar nga projektet		Punonjës vullnetar pagesë
								SIDA	ICMP	
Vitet	2016	5	5							
	2017	5	5	15	15		2			4
	2018	5	4	25	22	3	6			7
	2019*	5	4	35	27	3	14	1	1	12
	2020	5	4	45	42	1	4	1	2	7
	2021	5	4	55	48	3	4	1	3	7
	2022**	5	5	60	51	18	4	1		6
	2023***	5	5	73	64	13	4	0	0	3

Shpjegime:

* Fondi i pagave shtesë, për 10 punonjës të rinj, ka hyrë në fuqi me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 3.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019””

** Numri total i punonjësve të AIDSSH është bërë 65 punonjës, me Vendimin e Kuvendit nr.26/2022, datë 17.3.2022, “Per disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit Nr.95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””.

*** Numri total i punonjësve të AIDSSH është bërë 73 punonjës, me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr.19/2023, datë 16.3.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit Nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””.

12. TË DHËNA PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E AUTORITETIT

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për vitin 2023 administroi dhe menaxhoi fonde nga disa burime financimi, si më poshtë:

- I. Fondet nga Buxheti i Shtetit të miratuara me ligjin nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, sipas planit fillestar të buxhetit, në vlerën 132,651,000 lekë

- II. Të ardhurat dytësore, që realizohen në zbatim të VKM nr.93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve, apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”

I. FONDET BUXHETORE

Me ligjin nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit iu miratua numri i përgjithshëm prej 73 punonjësish dhe mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr. 19/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 95/2016 për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, ka ndryshuar dhe struktura e Autoritetit.

Për vitin 2023, me ligjin e buxhetit, fondet e akorduara për institucionin tonë janë 132,651,000 lekë. Me shkresën nr 1750/1, datë 08.02.2023, “Miratimi i detajimit të fondit të veçantë”, Autoritetit iu akordua vlera shtesë prej 100.000 lekë, në llogarinë 606 (transfera tek individët).

Në mbështetje të VKM nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, si dhe referuar Vendimit 26/2022, për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.12907/1, datë 02.08.2023, “Miratim i akordimit të fondeve shtesë”, Autoritetit iu alokuan fonde shtesë, për paga dhe sigurime, në vlerën 12.429.102 lekë, përkatësisht 11,450,410 në artikullin 600 (paga) dhe 978,692 lekë në artikullin 601 (kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore). Nga rishikimi i Buxhetit, me Aktin Normativ numër 6, datë 14.12.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë fondi i pagave u pakësua në vlerën 9,000,000 lekë, nga ku rezulton se plani i rishikuar i buxhetit, me shtesat dhe pakësimet, për vitin 2023 **është 136,180,653 lekë**.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, i planifikuar për vitin 2023, për 12-mujorin e vitit 2023, janë shpenzuar në total **129,003,308** lekë. Buxheti në tërësinë e tij, për periudhën, është realizuar në masën **95%**. (Aneks 3, tabela 1-3)

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore

Ky zë, është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar. Ky zë shpenzimesh është realizuar për numrin faktik të punonjësve, respektivisht në vlerën 78,153 mijë lekë për paga, si dhe 12,756 mijë lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rreth 96 % e fondit të planifikuar vjetor. Shpenzimet për paga, janë kryer për punonjësit faktikë në organikë dhe për punonjësit me kontratë.

Për vitin 2023, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, të miratuar me vendimin 56, datë 01.02.2023, është 20 punonjës. Aktualisht, janë 15 punonjës me kontratë, të cilët, janë paguar për punën e kryer (6 orë), duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime

Për 12-mujorin 2023, është realizuar në vlerën 31,208 mijë lekë, nga 36,751 që është plani. Në këtë zë, përfshihen fondi për shpenzime operative, në vlerën 36,251 mijë lekë dhe 500 mijë lekë janë transfera tek individët për pagesën e telefonisë celulare, si dhe pagesa nga fondi i veçantë.

Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 85 %, e planit total vjetor të shpenzimeve operative dhe është kryesisht, rezultat i fondeve të kursyera nga prokurimi.

Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)

Buxheti i akorduar në këtë zë shpenzimesh, për këtë vit buxhetor, është 7 000 mijë lekë, me një realizim faktik prej 6,880,000 lekë ose 98% e fondeve të planifikuara. Në vitin 2023, realizimi faktik i shpenzimeve kapitale është 100%, ndërsa ai financiar 98 %. Kjo diferencë është rezultat i kursimit të fondeve, si rezultat i prokurimeve⁴.

Realizimi faktik i Shpenzimeve për vitin 2023, i detajuar paraqitet në Aneks 3.

II. TË ARDHURAT DYTËSORE

Këto të ardhura realizohen në zbatim të VKM nr.93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve, apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

Për priudhën Janar- Dhjetor 2023, janë arkëtuar në total **206,800** lekë, nga të cilat:

1. Nga kërkesat studimore, janë arkëtuar në vlerën **122 710** lekë
2. Nga kërkesat individuale, janë arkëtuar në vlerën **84 090** lekë.

Të ardhurat e krijuara si më sipër, derdhen totalisht në buxhetin e shtetit, në kërkesë të vendimit të sipërcituar.

III. PROKURIMET

Në funksion të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2023, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në bazë të buxhetit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Autoritetin, për vitin 2023, në fillim të vitit është hartuar regjistri i parashikimeve për vitin 2023, ku janë parashikuar procedurat e prokurimit për shërbime dhe mallra të domosdoshme dhe të nevojshme për veprimtarinë e institucionit.

Janë zhvilluar një pjesë e konsiderueshme e procedurave të prokurimit, të parashikuara në Regjistrin e parashikimeve të vitit 2023, duke bërë që fondet e buxhetit të shtetit, të akorduara

⁴ Informacion të detajuar mbi realizimin e shpenzimeve kapitale i gjeni në Aneks 3

për Autoritetin, për vitin 2023, të realizohen në masën **87.96 %**. Procedura të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2023, janë realizimi i procedurës së Skanimit të dokumenteve arkivore, një element shuë i rëndësishëm në migrimin e të dhënave në programin (softin) e arkivës, si dhe realizimi i marrëveshjes kuadër për botimin e librave. Blerjet e pajisjeve kompjuterike, si dhe blerja e një mjeti transporti është një arritje e Autoritetit, duke qenë se janë të domosdoshme në aktivitetet. Një vend, jo pak të rëndësishëm në prokurimet e vitit 2023, zë dhe prokurimi i aktivitetet të shumta (konferenca, takime me palët e interesit, aktivitetet e kujtesës, punime etj)

Vlen të përmendet se, të gjitha procedurat e prokuruar, të realizuara apo jo, janë kryer në mënyrë transparente dhe me integritet të plotë nga njësitë e prokurimit, komisionet e vlerësimit të ofertave, komisionet e shqyrtimit të ankesave dhe të marrjes në dorëzim.

Përkthyer në shifra, planifikimi i regjistrimit të parashikimeve të Autoritetit dhe realizimi i tij për vitin 2023 në vlerën **33,152** mijë lekë, me një realizim vjetor në vlerën prej **29,162** mijë lekësh ose **87.96%**.

IV. LOGJISTIKA

Gjatë vitit 2023, është mundësuar blerja e një mjeti transporti që ka mundësuar infrastrukturën e nevojshme për lehtësimin e punës së stafit për realizimin e aktivitetet të institucionit. Janë kryer procedurat për sigurim të objektit dhe pajisjeve, si dhe është kontraktuar me kompanitë e sigurimit, me qëllim mbrojtjen e investimit nga dëmtimet.

Janë ruajtur dhe mirëmbajtur aktivet në pronësi të Autoritetit. Është siguruar mbarëvajtja e eventeve të organizuara nga Autoriteti, ku përfshihet suporti teknik, transporti i materialeve, menaxhimi i hapësirave dhe burimeve njerëzore për kryerjen e tyre.

V. KALLËZIMET PENALE DHE PROCESET GJYQËSORE, KU INSTITUCIONI KA QENË PALË NË PROCES

Më poshtë, renditen të detajuara çështjet gjyqësore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit në proceset gjyqësore, ku institucioni ka qenë palë në proces, për vitin 2023

Nr.	Paditës	Faza e procesit	Komente
1	G.Gj.	Çështje Gjyqësore në proces në Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	Paditësi G. Gj. avokat dhe përfaqësues ligjor i shtetasit I.M. me objekt “Detyrimin e organit administrativ Autoriteti për Informimin mbi Dosjet e Ish- Sigurimit të Shtetit për të kryer veprimin administrativ pajisjen e kërkuar me aktet e kërkuara me kërkesën e datës 14.09.2022” (për dhënien e gjithë akteve që Autoriteti disponon në lidhje me të përfaqësuarin nga avokati G.Gj., të përpiluara apo të administruara nga Autoriteti në lidhje me shtetasin I. M.). Me vendimin nr. 848 datë 18.04.2023 Gjykata ka vendosur rrezimin e e kërkesë padisë së paraqitur nga Av. G. GJ. si të pabazuar në ligj e në prova.

4	I.M.	Çështje Penale në proces në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë	Kallëzimi penal i vitit 2022 i shtetasit I.M. drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kundër anëtarëve të Autoritetit. Prokuroria ka vendosur mos-fillimin e procedimit penal, pasi nuk ka vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka pranuar ankimin e bërë nga kallëzuesi dhe ka rrëzuar vendimin e Prokurorisë për mos fillimin e hetimeve. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka paraqitur ankim kundër vendimit të Gjykatës Penale të Shkallës së Parë. Çështja është në proces.
----------	-------------	---	---

A N E K S E

ANEKS 1

AUTORITETI NË MEDIA

❖ **Top News, A2 CNN, News 24, Tv Klan, Ora News, Vizion Plus, Report TV**

Gjen pasqyrim lajmi Kreu i Delegacionit të BE-së, Znj. Christiane Hohmann mbështet Autoritetin në misionin e zbardhjes e së të shkuarës komuniste.

Syri.net - “Pasqyruar ekspozita përkujtimore e organizuar nga AIDSSH, nën titullin: “Të ZGJEDHUR”, ekspozitë përkujtimore në 76-vjetorin e ekzekutimit politikë të deputetëve dhe intelektualëve më 10 tetor 1947”: <https://www.syri.net/arte-media/630243/te-zgjedhur/>

❖ **Shqiptarja.com** - “Ekspozitë në oborrin e Kuvendit në nder të 16 deputetëve të ekzekutuar në 1947! Historiana, Nika: Duajeni Atdheun, mos ikni”: <https://shqiptarja.com/lajm/te-zgjedhurit-ekspozite-ne-oborrin-e-kuvendit-ne-nder-te-16-deputeteve-te-ekzekutuar-ne-1947-nga-regjimi-komunist-historiana-nika-duajeni-atdheun-mos-ikni>

❖ **Gazeta Tema.net** - “Të ZGJEDHUR”, ekspozitë përkujtimore në 76-vjetorin e ekzekutimit politikë të deputetëve dhe intelektualëve më 10 tetor 1947”:

<https://www.gazetatema.net/dossier/te-zgjedhur-ekspozite-perkujtimore-ne-76-vjetorin-e-ekzekutimit-politike-i410459>

❖ **Droni.al** - “Përkujtohen deputetët e ekzekutuar të opozitës më 1947! Sula: Paganan idealet e tyre demokratike, me jetë”:

<https://www.droni.al/2023/10/12/perkujtohen-deputetet-e-ekzekutuar-te-opozites-me-1947-sula-paguan-idealet-e-tyre-demokratike-me-jete/>

❖ **Vizionplus.tv** - “Të Zgjedhur”/ Ekspozitë përkujtimore në 76-vjetorin e ekzekutimit politikë të deputetëve dhe intelektualëve më 10 tetor 1947:

<https://www.vizionplus.tv/te-zgjedhur-ekspozite-perkujtimore-ne-76-vjetorin-e-ekzekutimit-politike-te-deputeteve-dhe-intelektualeve-me-10-tetor-1947/>

❖ **Oranews.tv** - 76-vjetori i vrasjes së deputetëve, çelet në ambientet e jashtme të Kuvendit ekspozita “Të zgjedhurit”:

- <https://www.oranews.tv/kultura/76-vjetori-i-s-se-deputeteve-celet-ambientet-e-jashtme-te-kuvendit-i1114484>
- ❖ ARTE - “Shqipëria po pajtohet me të shkuarën” (Reportazh realizuar nga gazetarja franceze, Morgane Belloir dhe transmetuar në TV franko-gjermane, ARTE):
<https://m.youtube.com/watch?si=Ah6Px-R8KrrICKL-&v=a7R5xuiXnOA&feature=youtu.be>
 - ❖ ARTE - “Albania faces its dark past”:
<https://www.arte.tv/en/videos/111777-005-A/re-albania-faces-its-dark-past/>
 - ❖ RTV Klan - “Tepelena, nga Ali Pasha te kampi famëkeq komunist” (Një familje në 8 metër katror”, horrori i kampit të Tepelenës):
<https://www.youtube.com/ëatch?v=2JizjiuepHQ>
 - ❖ Droni.al - “Çmimi i mirënjohjes UET, për kryetaren e Autoritetit të dosjeve, Gentiana Sula”:
<https://www.droni.al/2023/11/15/cmimi-i-mirenjohjes-uet-per-kryetaren-e-autoritetit-te-dosjeve-gentiana-sula/>
 - ❖ Shqiptarja.com - 'Tirana në sytë e Sigurimit të Shtetit'/ Prezantohet “DOSJA E HAPUR” e Xhahit Toptanit dhe Abdyl Këllezit:
<https://shqiptarja.com/lajm/te-sakrifikuarit-tirana-ne-syte-e-sigurimit-prezantohet-dosja-e-hapur-e-xhahit-toptani-dhe-abdyl-kellezit>
 - ❖ BalkanWeb - “Petro Marko, Safet Butka, Isuf Luzaj, Fundo, Karapici/ Profile antifashiste, nga Ventotene në burgjet komuniste”. (Për fatet dhe rolin e tyre në histori, shkruan studiuesja Ardita Repishti, nga “Istituto Storico Italiano per l’Età Moderna e Contemporanea”, në studimin: “Internimet politike të shqiptarëve gjatë pushtimit italian, profilet antifashiste gjatë luftës dhe pas saj”, mbajtur në simpoziumin e AIDSSH: “Tepelena në dy kohë - Nga kazermat italiane te kampi me tela me gjemba”, mbajtur në gusht, në kuadër të Ditës Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, fashizmit, nazizmit e komunizmit):
<https://www.balkanweb.com/petro-marko-safet-butka-isuf-luzaj-fundo-karapici-profile-antifashiste-nga-ventotene-ne-burgjet-komuniste/>
 - ❖ Shqiptarja.com - “Të dënuar tri herë, nga fashizmi, komunizmi dhe lënia në harresë përgjatë historisë!”:
<https://shqiptarja.com/lajm/të-dënuar-tri-herë-nga-fashizmi-komunizmi-dhe-lënia-në-harresë-përgjatë-historisë>
 - ❖ BalkanWeb - “Vrasjet në kufi, nis hetimi i parë administrativ për të zhdukurit në Kolonjë”:
<https://www.balkanweb.com/vrasjet-ne-kufi-nis-hetimi-i-pare-administrativ-per-te-zhdukurit-ne-kolonje/>
 - ❖ Syri.net - “Vrasjet në kufi, AIDSSH nis hetimin e parë administrativ për të zhdukurit në Kolonjë”:
<https://www.syri.net/kronike/645664/vrasjet-ne-kufi-aidssh-nis-hetimin-e-pare-administrativ-per-te-zhdukurit-ne-kolonje/>

- ❖ A2 CNN-“Vrasjet në kufi gjatë komunizmit, nisin për herë të parë kërkimet për të zhdukurit në Kolonjë”:
<https://a2news.com/shqiperia/aktualitet/t-ne-kufi-gjate-komunizmit-nisin-per-here-te-pare-ker-i1110283>
- ❖ Shqiptarja.com -“Vrasjet në kufi, Autoriteti i Dosjeve nis hetimin e parë administrativ për të zhdukurit në Kolonjë”:
<https://shqiptarja.com/lajm/vrasjet-ne-kufi-autoriteti-i-dosjevenis-hetimin-e-pare-administrativ-per-te-zhdukurit-ne-kolonje>
- ❖ TV Klan -“Deklasifikohet dosja për Mehmet Shehun”:
<https://www.youtube.com/ëatch?v=mB-0q55m5E8>
- ❖ Shqiptarja.com - “Kush dhe pse e vrau Mehmet Shehun? Autoriteti i Dosjeve deklasifikon 30 mijë faqe, me dokumente për ish-kryeministrin! Çfarë shkruanin diplomatët perëndimorë”:
<https://shqiptarja.com/lajm/kush-dhe-pse-e-vrau-mehmet-shehun-autoriteti-i-dosjeve-deklasifikon-30-mije-faqe-me-dokumente-per-ishkryeministrin-cfare-shkruanin-diplomatet-perendimore>
- ❖ Tv Klan - “Deklasifikohet dosja për Mehmet Shehun”:
<https://tvklan.al/deklasifikohet-dosja-per-mehmet-shehun/>
- ❖ TV Klan - “Deklasifikohen dokumentet për vdekjen e Mehmet Shehut”:
<https://tvklan.al/deklasifikohen-dokumentat-per-vdekjen-e-mehmet-shehut/>
- ❖ Fax.al - “Kush e vrau Mehmet Shehun? Autoriteti i dosjeve deklasifikon 30 mijë faqe dokumente për ish-kryeministrin”:
<https://fax.al/news/39436360/kush-e-vrau-mehmet-shehun-autoriteti-i-dosjeve-deklasifikon-30-mije-faqe-dokumente-per-ish-kryeministrin>
- Ina-Online.net-“Kush dhe pse e vrau Mehmet Shehun? Deklasifikohen dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”:
<https://ina-online.net/kush-dhe-pse-e-vrau-mehmet-shehun-deklasifikohen-dokumentet-e-ish-sigurimit-te-shtetit/>
- Syri.net -‘Kush dhe pse e vrau Mehmet Shehun?’, AIDSSH deklasifikon 30 mijë faqe dokumente, për ish-Kryeministrin:
<https://www.syri.net/kronike/647598/kush-dhe-pse-e-vrau-mehmet-shehun-aidssh-deklasifikon-30-mije-faqe-dokumente-per-ish-kryeministrin/>
- Gazeta Tema.net - “Kush dhe pse e vrau Mehmet Shehun? Deklasifikohen dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit:
<https://www.gazetatema.net/dossier/kush-dhe-pse-e-vrau-mehmet-shehun-deklasifikohen-dokumentet-e-ish-siguri-i419381>
- Java News - “Deklasifikohen dokumentat për vdekjen e Mehmet Shehut”:
<https://javanews.al/deklasifikohen-dokumentat-per-vdekjen-e-mehmet-shehut/>
- Shqiptarja.com - “Dosjet e Policisë Sekrete për historinë e regjimit komunist në shkollë?! Autoriteti çel debatin, Sula: Jo si mjet propagande, por revolucionarizim i mësimdhënies”:

<https://shqiptarja.com/lajm/dosjet-e-policise-sekrete-per-e-historine-e-regjimit-komunist-ne-shkolla-autoriteti-cel-debatin-sula-jo-si-mjet-propagande-por-revolucionarizim-te-mesimdhenies>

- **RTSH** - “Informimi mbi të shkuarën, nevoja e njohjes edukuese, me dosjet e ish-Sigurimit” (Ja sesi do të funksionojë edukimi dhe njohja, mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit):

<https://www.youtube.com/ëatch?v=yvGmsiUdgBc>

- **Top Channel** - “Spaç, historia e një revolte”, të rinjtë të njohin historinë e dhimbshme të persekutimit komunist”:

<https://top-channel.tv/2023/12/19/spac-historia-e-nje-revolte-te-rinjte-te-njohin-historine-e-dhimbshme-te-persekutimit-komunist0/>

- **BalkanWeb** - “Dosjet e policisë sekrete në shkolla”, projekti që nxit zbulimin e së shkuarës të nxënësit” (Seminar ndërkombëtar mbi “Përdorimin e dosjeve të policisë sekrete në mësimin e historisë së regjimeve totalitare”, organizuar nga Autoriteti i Dosjeve dhe Ministria e Arsimit, me mbështetjen e departamentit të Arsimit pranë Këshillit të Evropës. Synimi i nismës është që nxënësit e shkollave, të mësojnë të shkuarën përmes mënyrave kreative, shpesh edhe duke plotësuar mangësitë e trashëguara në dije, nga një brez në tjetrin):

<https://www.balkanweb.com/dosjet-e-policise-sekrete-ne-shkolla-projekti-qe-nxit-zbulimin-e-se-shkuares-te-nxenesit/>

ANEKS 2

REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2023


Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, realizimi i shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” krahasuar me planin vjetor, paraqitet si më poshtë

Tabela 1

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2023	Buxheti I rishikuar Viti 2023	Realizimi faktik 2023	
				Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	132,651	136,180	129,004	95 %

Me poshte paraqitet grafikisht plani dhe realizimi i planit te buxhetit per vitin 2023




Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik, për periudhën janar-dhjetor 2023:

Tabela 2

Në mijë lekë

Llog	Emërtimi	Buxheti Fillestar Viti 2023	Buxheti I rishikuar Viti 2023	Realizimi faktik Viti 2023	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	75,900	78,350	78,153	100 %
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	13,100	14,079	12,756	91 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	36,521	36,251	30,881	85 %
606	Transferte të individët	400	500	327	65 %
231	Kapitale të Trupëzuara	7,000	7,000	6,887	98 %
	T o t a l i	132,651	136,180	129,004	95 %

Më poshtë, paraqitet grafiki për përbërja e buxhetit sipas klasifikimit buxhetor për vitin 2023



Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)

Buxheti i akorduar në këtë zë shpenzimesh, për këtë vit buxhetor është 7 000 mijë lekë, me një realizim faktik prej 6,880,000 lekë ose 98% e fondeve të planifikuara. Në vitin 2023, realizimi faktik i shpenzimeve kapitale është 100%, ndërsa ai financiar 98 %. Kjo diferencë është rezultat i kursimit të fondeve si rezultat i prokurimeve⁵ (për më shumë informacion, aneksi 3)

1- **Projekti M950002**- llog 231, në vlerën 1,000,000 lekë, me emërtimin “Blerje orendi, mobilie zyre”, është realizuar në vlerën 997,104 lekë ose 98% e fondit vjetor të planifikuar.

2-**Projekti 18BV402**- llog 231, në vlerën 6,000,000 lekë “Blerje pajisje informatike”, është realizuar plotësisht, në vlerën 3,511,680 lekë dhe fondi i kyrsyer nga prokurimi, në vlerën 2,488,320, është rialokuar për blerje makine për Autoritetin.

3- **Projekti 18BV403**-llog 231, në vlerën 2,488,320 lekë, “Blerje mjet transporti”, është realizuar në vlerën 2,397,600 lekë ose 96% e fondit total

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2023

Tabela 3

Nr	Llogaria ekonomike	Emertimi i shpenzimit	Buxheti I rishikuar 2023	Realizimi i buxhetit 2023
----	--------------------	-----------------------	--------------------------	---------------------------

⁵ Informacion të detajuar mbi realizimin e shpenzimeve kapitale i gjeni në Aneks 3

			136,180,102	129,003,653
1	600	PAGA	78,350,410	78,153,206
2	601	SIGURIME SHOQËRORE	14,078,692	12,755,947
	602	SHPENZIME OPERATIVE	36,751,000	31,207,316
	6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme		0
1	6020100	Kancelari	850,000	833,640
2	6020200	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	500,000	378,000
3	6020500	Rregjistra të arkivës & blerje libra	120,000	118,600
4	6020900	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme	120,000	61,720
	6021	Materiale dhe shërbime speciale		0
1	6021002	Blerje lule natyrale me vazo	120,000	119,400
2	6021007	Blerje libra për bibliotekën	120,000	100,800
3	6021007	Botime, dizain, libra dhe publikime profesionale	3,000,000	2,846,100
	6022	shërbime nga të tretë		0
1	6022001	Energjia	2,400,000	2,384,420
2	6022002	Ujë	168,200	128,544
3	6022003	Telefoni fikse	120,000	92,160
4	6022003	Shërbim interneti	120,000	120,000
5		Sim card për sistemin e sigurisë	28,800	0
6	6022004	Posta dhe shërbimi korrier	100,000	87,035
7	6022009	Dezinfektim	100,000	96,360
8	6022010	shërbime të printimit dhe publikimit nga të tretë	600,000	294,400
9	6022099	shërbim skanimit	9,000,000	8,999,400
10	6022099	Shërbime të përkthimit	1,200,000	612,463
11	6022099	Shërbim dizajnim Webside	100,000	100,000
12	6022099	Zhvillim konceptim artistik të materialeve audiovizuale	1,000,000	978,000
13	6022099	Pagesë ekspert i jashtëm	2,882,000	2,275,734
	6023	Shpenzime transporti		0
1	6023100	Karburant dhe vaj	570,000	543,640
2	6023200	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	90,000	75,600
3	6023300	Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit	40,000	18,232
4	6023900	Shpenzime për taksa automjeti	40,000	16,976
	6024	Shpenzime udhëtimi		0
1	6024100	Udhëtim i brendshëm	500,000	454,980
2	6024200	Udhëtim jashtë shtetit (Dieta)	3,000,000	2,446,961

3	6024200	Udhëtim jashtë shtetit (Bileta)	2,300,000	1,089,530
	6025	Shpenzime për mirëmbajtje		0
1	6025300	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore.	120,000	115,466
2	6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e programit Alpha	120,000	117,840
3	6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e programit (softwerit) të arkivës digjitale	1,440,000	1,440,000
4	6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike	120,000	119,800
5	6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen HVAC	800,000	400,800
6	6025600	Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	120,000	88,676
7	6025600	Shpenzime për larje të automjeteve	72,000	48,600
	6026	Shpenzime qiramarrje		0
1	6026100	Shpenzime qiramarrje ambientesh	200,000	90,000
2	6026400	Shpenzime qiramarrje mjet transporti	650,000	408,000
3	6026400	Shpenzime transporti nga të tretët	200,000	125,952
	6029	Shpenzime të tjera operative		0
1	6029001	Shpenzime për artikuj dhe shërbime protokollare	120,000	119,719
2	6029004	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	1,200,000	998,833
3	6029005	Shpenzime për pagesën e anëtarëve të komisioneve	300,000	272,750
4	6029007	Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca	1,200,000	921,395
5	6029008	Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga institucioni	40,000	33,227
6	6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	120,000	114,000
7	6022099	Shërbime të tjera	120,000	74,280
8	6029099	Shpenzime të tjera operative të papërcaktuara	120,000	118,500
	606	Transferta tek individë		0
1	6061099	Telefoni Celular, transfera	500,000	326,783
		INVESTIME	7,000,000	6,887,184
1	231	Mobilie orendi	1,000,000	977,904
2	231	Pajisje informatike	3,511,680	3,511,680
3	231	Blerje mjet transporti	2,488,320	2,397,600

Diferenca në realizimin e fondeve të parashikuara, lidhet kryesisht me fondet e kursyera, si rezultat i procedurave të prokurimit.

Një pasqyrë e detajuar në lidhje me pozicionet, kategoritë përkatëse, numrin dhe llojin e procedurave të rekrutimit, të shpallura dhe të zhvilluara gjatë vitit 2023, për procedurat e

pashpalluar të rekrutimit, si për ato të parshikuara në planin e rekrutimeve për vitin 2023, por edhe për vendet vakante, të krijuara si rezultat i lëvizjeve të punonjësve ekszisutes, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4

Numri total i njoftimeve për shpalljen procedurave të rekrutimit	32
Numri total i procedurave të pranimit në kategorinë e lartë drejtuese të zhvilluara	2
Numri total i procedurave të lëvizjes paralele të zhvilluara	8
Numri total i procedurave të ngritjes në detyrë të zhvilluara	10
Numri total i procedurave të pranimit në shërbimin civil për katëgorinë ekezekutive të zhvilluara	16
Numri total i procedurave të pranimit në kategorinë e lartë drejtuese të suksesshme	2
Numri total i procedurave të lëvizjes paralele të suksesshme	4
Numri total i procedurave të ngritjes në detyrë të suksesshme	10
Numri total i procedurave të pranimit në shërbimin civil për katëgorinë ekezekutive të suksesshme	12
Numri total i procedurave të ngritjes në detyrë të pasuksesshme	4
Numri i kandidatëve të interesuar, që kanë paraqitur kërkesë dhe dokumentacionin e kërkuar	66
Numri i kandidatëve të kualifikuar për në fazën e dytë të vlerësimit	51
Nr. ankimeve të kandidatëve të pakualifikuar	3
Numri i kandidatëve që kanë kaluar kufirin prej 70 pikësh	34
Nr. ankimeve për rezultatet e vlerësimit	1
Numri i kandidatëve fitues të punësuar	31